


DORACAK PËR  
PJESËMARRJEN DHE  
AKTIVIZMIN E  
NXËNËSVE







DORACAK PËR  
PJESËMARRJEN DHE  
AKTIVIZMIN E  
NXËNËSVE



## DORACAK PËR PJESËMARRJEN DHE AKTIVIZMIN E NXËNËSVE

Publikues: Fondacioni për iniciativa arsimore dhe kulturore “Нар пас хапи”

Për publikuesin: Suzana Kiranxhiska

Autorë: Elizabeta Markovska Spasenoska dhe Tomislav Gajtanovski

Redaktim profesional: Suzana Kiranxhiska

Kryeredaktor: Suzana Kiranxhiska

Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe: Sihana Kaba

Dizajn grafik: Lidija Bozik

Qarkullimi: 100

Shkupi, 2021

Ky botim është i financuar nga Qeveria Suedeze.

Përgjegjësia për përmbajtjen qëndron tek zhvilluesi i saj.

Qeveria Suedeze jo domosdoshmërisht i ndan pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3(497.7)(035)

MARKOVSKA Spasenovska, Elizabeta

Doracak për pjesëmarrjen dhe aktivizmin e nxënësve / [autorë  
Elizabeta Markovska Spasenovska, Tomislav Gajtanovski ; ërktheu nga  
gjuha maqedonase në gjuhën shqipe Sihana Kaba]. - Shkup : Fondacioni për  
iniciativa arsimore dhe kulturore “Нар пас хапи”, 2021. - 51 стр. :  
илустр. ; 30 см

Превод на делото: Прирачник за ученичко учество и активизам

ISBN 978-608-4857-71-6

1. Gajtanovski, Tomislav [автор]

а) Основно образование -- Ученички активизам -- Македонија -- Прирачници

COBISS.MK-ID 55613189

# Përmbajtja

Parathënie .....	7
1. Dokumentat themelore të cilat rregullojnë pjesëmarrjen e nxënësve në shkolla .....	9
1.1 Konventa për të drejtat e fëmijëve .....	9
1.2 Ligji për arsimin fillor .....	11
1.3 Dokumente të tjera me të cilat rregullohet pjesëmarrja e nxënësve .....	12
2. Koncepti pjesëmarrje e nxënësve .....	13
2.1 Përkufizimi i nocionit .....	13
2.2 Shkalla e pjesëmarrjes .....	15
2.3 Palët e kyçura në procesin e pjesëmarrjes së nxënësve .....	16
2.4 Standardet e pjesëmarrjes së nxënësve .....	18
2.5 Modelet e pjesëmarrjes së nxënësve.....	20
3. Krijimi i parlamentit të nxënësve .....	23
3.1 Kuptimi për parlamentin e nxënësve .....	23
3.2 Hapat për krijimin e parlamentit të nxënësve .....	25
3.3 Funkcionaliteti i parlamentit të nxënësve .....	25
4. Shkathtësitë e përfaqësuesëve në parlamentin e nxënësve .....	28
4.1 Shkathtësitë komunikative.....	28
4.2 Debatet .....	33
4.3 Shkathtësitë hulumtuese dhe analitike .....	38
4.4 Shkathtësitë për prezentim.....	41
5. Përgaditja dhe realizimi i iniciativave të nxënësve .....	46
5.1 Kuptimi për iniciativat e nxënësve, aktivizmi dhe vullnetarizmi .....	46
5.2 Identifikimi i ideve dhe temave për aktivitetet e nxënësve .....	47
5.3 Hapat për planifikim dhe zbatim të iniciativave dhe aksioneve.....	48
5.4 Metodat për realizimin e iniciativave dhe aksioneve.....	50
5.5 Resurse për arsimtarë dhe nxënës.....	53



Dorracaku për pjesëmarrjen dhe aktivizmin e nxënësve është dedikuar për nxënësit, arsimtarët, kuadrin profesional dhe udhëheqësinë nëpër shkollat fillore. Qëllimi kryesor i dorracakut është që në mënyrë praktike të ndihmon në realizimin e të drejtave për pjesëmarrje të nxënësve në proceset e vendim-marrjes në shkollë dhe në realizimin e aktiviteteve dhe projekteve në interes të tyre. Dorracaku është një pjesë nga dhe e ndjek dhe plotëson përmbajtjen e trejnimeve dhe punëtorive në kuadër të projektit “Edhe unë kam zë” zbatuar nga Fondacioni për inicijativa arsimore dhe kulturore “Hap pas hapi”, përkrahur nga Agjensioni suedez për zhvillim (SIDA).

Dorracaku është përgatitur në pajtueshmëri me ligjet themelore ndërkombëtare dhe kombëtare, aktet nënligjore dhe dokumentet tjera, nëpërmjet të të cilave rregullohet pjesëmarrja e nxënësve në arsimin fillor. Në këtë kontekst, Dorracaku në mënyrë direkte e ndihmon procesin e zbatimit të Ligjit për Arsimin Fillor të miratuar në qershor 2019, edhe atë konkretisht në lidhje me nenin 68, i cili nen rregullon pjesëmarrjen e nxënësve dhe organet përfaqësuese të nxënësve në shkollën fillore.

Dorracaku përmban pesë tërësi edhe atë:

1. Dokumenta bazë, të cilat e rregullojnë pjesëmarrjen e nxënësve nëpër shkollë
2. Koncepti pjesëmarrje e nxënësve
3. Krijimi i parlamentit të nxënësve
4. Shkathtësitë e përfaqësuesve në parlamentin e nxënësve
5. Përgaditja dhe realizimi i inicijativave (nismave) të nxënësve

Besojmë se nëpërmjet këtij Dorracaku, do t’i nxisim nxënësit, parasëgjithash ato, të cilët morën pjesë aktive në punëtoritë e realizuara, që të fillojnë me organizimin dhe inicimin e aktiviteteve të Parlamentit të nxënësve dhe në atë mënyrë do t’a përmirësojnë jetën e nxënësve dhe kualitetin e kohës së kaluar në bankat shkollore. Në mënyrë plotësuese, mendojmë se, të gjithë arsimtarët, përfaqësuesit e shërbimit profesional dhe udhëheqësia e shkollës, të cilët në mënyrë aktive i ndoqën punëtoritë, tash më do të kenë kuptim më të gjërë rreth implementimit praktik të pjesëmarrjes së nxënësve, dhe nëpërmjet këtij Dorracaku do të mundën t’ju japin përkrahjen e duhur nxënësve, në realizimin e ideve të tyre.





# 1. Dokumentat themelore të cilat e rregullojnë pjesëmarrjen e nxënësve nëpër shkolla

## 1.1 Konventa për të drejtat e fëmijëve

### Çka është Konventa për të drejtat e fëmijës?

Konventa për të drejtat e fëmijës (Konventa) është dokument/marrëveshje ndërkombëtare, e cila është miratuar nga ana Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1989. Konventa në vete përfshin një spektër të gjërë të të drejtave të fëmijëve, të cilat janë të përmbledhura në katër grupe, edhe atë: të drejtat e mbijetesës, të drejtat për zhvillim, të drejtat për mbrojtje dhe të drejtat për pjesëmarrje.

**MBIJETESA** Në këtë segment përfshihen të drejtat e fëmijëve për jetë dhe nevojave, përmbushja e të cilave është më se e nevojshme për mbijetesë. Këtu bëjnë pjesë të drejtat për një standard të përshtatshëm jetese, shtëpi, ushqim dhe qasja në shërbimet shëndetësore.




**ZHVILLIMI** Në këtë segment përfshihen ato gjëra, të cilat janë të nevojshme për fëmijët, që të rrisin potencialin e tyre. Këtu bëjnë pjesë e drejta për arsimim, lojë dhe pushim, aktivitete kulturore, qasje deri te informacionet, liria e të menduarit, ndërgjegjes dhe fesë.

**MBROJTJA** Detyrim ligjor për të mbrojtur fëmijët nga secili lloj i keqpërdorimit, neglizhencës ose shfrytëzimit. Këto të drejta përfshijnë pyetje siç janë: kujdes i veçantë për fëmijët refugjatë, shfrytëzimi i fëmijëve në konflikte të armatosura, puna e fëmijëve, keqpërdorimi i substancave psihotrope dhe shfrytëzimi seksual.

**PJESËMARRJA** Ju mundësohet fëmijëve që të marrin rol aktiv në shoqëri. Këtu bëjnë pjesë liria e të menduarit dhe të shprehurit, e drejta për të ngritur zërin për pyetje, të cilat kanë të bëjnë me jetën e tyre, e drejta për t'u bashkuar dhe e drejta për tubim paqësor.

Konventa është një akt ligjor i detyrueshëm për të gjitha vendet, të cilat e kanë ratifikuar, gjegjësisht e kanë pranuar. Shteti nënshkruar i Konventës ka për detyrim që t'i kyç të drejtat e fëmijës, të cilat janë përfshirë me këtë Konventë në një kornizë legjislativë ( ligjet dhe aktet nënligjore) dhe zbatimi si dhe praktika, të realizohet në përputhje me principet e Konventës.




Fakte nga Konventa për të drejtat e fëmijës:

-  Shteti ynë e ratifikoi Konventën për të drejtat e fëmijëve në vitin 1993.
-  Shteteve ju është nevojitur 10 vite që të merren vesht për tekstin e Konventës.
-  Deri më sot, 196 vende anëtare të Kombeve të Bashkuara e kanë ratifikuar Konventën.

## Të drejtat për pjesëmarrje të fëmijëve

Pjesëmarrja si koncept është e drejtë njerëzore, dhe prej aty edhe e drejtë e fëmijëve që të jenë pjesëmarrës aktiv në proceset e sjelljes së vendimeve, të cilat vendime kanë të bëjnë me jetën dhe mirëqenien e tyre. Pjesëmarrja nënkupton ushtrimin e të drejtës demokratike të njeriut dhe të fëmijëve, për të marrë pjesë në të gjitha sferat e jetës shoqërore, dhe në këtë mënyrë të zhvillojnë vazhdimisht kapacitetin e tyre demokratik për t'u bërë qytetarë aktivë të vendit të tyre. Spektri i të drejtave të pjesëmarrjes përfshin lirinë e shprehjes së fëmijëve, të drejtën për të ngritur zërin kur bëhet fjalë për çështje që kanë të bëjnë me jetën e tyre, të drejtën e shoqërimit dhe të drejtën e tubimit paqësor.

Trekëndëshi i të drejtave të fëmijëve përfshin tre të drejta kyçe:


-  Interesi më i mirë për fëmijën ( neni 3 nga Konventa)
-  Jodiskriminimi (neni 2 nga Konventa)
-  E drejta për pjesëmarrje (neni 12 dhe neni 15 nga Konventa)

Që të përcaktohet se cili është interesi më i mirë për fëmijën, është logjike dhe e domosdoshme që të dëgjohet zëri i fëmijës dhe qëndrimet e tij të merren parasysh me seriozitetin më të madh.

Sipas nenit 12 nga Konventa për të drejtat e fëmijës, fëmijët kanë të drejtë që lirisht të shprehin mendimin e tyre të cilit mendim duhet që t'i kushtohet vemendje sipas pjekurisë të moshës.

Sipas nenit 15, fëmijët kanë të drejtë në shoqëri dhe në lirinë e tubimeve paqësore.

Pjesëmarrja e nxënësve është e një rëndësie të veçantë për pjesëmarrjen e fëmijëve në jetën shoqërore. Fëmijët kalojnë një pjesë të madhe nga koha e tyre, duke u rritur dhe zhvilluar në shkollë si një institucion arsimor. M'u përkëtë, pjesëmarrja e tyre në vendim-marrjen e shkollës, për çështje që janë të rëndësishme për ta si nxënës, duhet të rregullohet siç nevojitet dhe, dispozitat ligjore duhet të zbatohen në mënyrë praktike në përditshmërinë shkollore.



## 1.2 Ligji për Arsimin fillor

### Çka rregullon Ligji për Arsimin fillor?

Me ligjin e ri për Arsimin fillor, miratuar në vitin 2019 rregullohet e drejta për pjesëmarrje dhe organizim të nxënësve. Në këtë ligj, e drejta për pjesëmarrje është e rregulluar në nenin 68, në të cilin parashihen format e pjesëmarrjes dhe vendet, ku duhet të kyçen nxënësit në proceset e vendim-marrjes. Para kësaj, Parlamenti i nxënësve dallohet si organ përfaqësues i gjithë nxënësve, nëpërmjet të të cilit, ata marrin pjesë në proceset e vendim-marjeve.

Roli i Parlamentit të nxënësve, në përputhje me Ligjin për arsimin fillor, është parashikuar në segmentet vijuese:

- 🌀 Pjesëmarrje aktive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të nxënësve;
- 🌀 E promovon aktivizmin e nxënësve;
- 🌀 Është pjesëmarrës në aktivitetet e nxënësve për sigurimin e përkrahjes ndërmoshatare të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, në realizimin e mësimi dhe aktivitetëve jashtëmësimore;
- 🌀 Merr pjesë në planifikimin e Programës për punë vjetore;
- 🌀 Jep propozim aktivitetet për Programin vjetor për Ekskurzione;
- 🌀 Jep propozime për aktivitetet jashtëmësimore në shkollë;
- 🌀 Jep propozime për përmirësimin e standardit të nxënësve në shkollë;
- 🌀 Merr pjesë në Evaluimin e punës së shkollës;
- 🌀 Nëpërmjet përfaqësuesve të vet, merr pjesë në Këshillin e prindërve dhe të arsimtarëve;
- 🌀 Organizon dhe merr pjesë në aktivitetet humanitare, aktivitetet ekologjike dhe punë të tjera të dobishme shoqërore.

Përveç Parlamentit të nxënësve, në këtë nen të Ligjit, rregullohet edhe zgjedhja e Kryetarit të Parlamentit të nxënësve dhe Avokati mbrojtës i nxënësve.

„Kryetari i Parlamentit të nxënësve zgjedhet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i përfaqësuesve të kryetarëve të bashkësive të paraleleve me votim të fshehtë,„

„Avokati mbrojtës i nxënësve, kujdeset për sigurinë dhe përparimin e të drejtave të nxënësve në shkollë. Avokati mbrojtës i nxënësve zgjedhet me shumicë votash të nxënësve prej klasës së shtatë deri në klasën e nëntë, me votim të fshehtë,„

## 1.3 Dokumente të tjera, me të cilat rregullohet pjesëmarrja e nxënësve

### Koncepti për arsimin fillor<sup>1</sup>

Pjesëmarrje e nxënësve është e rregulluar në kuadër të dokumentit “Koncepti për arsimin fillor,, edhe atë në pjesën Standardet nacionale për arsimin fillor, ku janë parashikuar kompetencat, të cilat nxënësit duhet që t’i arrijnë nëpërmjet arsimit. Koncepti për arsimin fillor është miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 2 mars të vitit 2021.



Pjesëmarrja e nxënësve është e rregulluar në kapitullin VI. Kultura demokratike dhe qytetërimi. „Në këtë kapitull bëjnë pjesë kompetencat, të cilat kanë të bëjnë me njohjen dhe të kuptuarit e vetes, shoqërisë dhe organizimin e saj, konceptet ekonomike dhe politike, strukturat dhe lëvizjet si dhe shkathtësitë dhe qëndrimet , të cilat, duhet që t’ju mundësojnë nxënësve që të sillen si qytetarë të përgjegjshëm dhe të motivuar e aktiv, të marrin pjesë në jetën qytetare dhe shoqërore,,. Më tej, pjesëmarrja e nxënësve është e rregulluar edhe në segmentin e Klima dhe kultura shkollore ku në mënyrë më precize parashihet:,, Respekti për të gjithë nxënësit, arsimtarët, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe gjithë të punësuarve të tjerë në shkollë, që është siguruar nëpërmjet udhëheqjes demokratike nga ana e drejtorëve, të cilët sigurojnë që në mënyrë transparente dhe demokratike të sillen rregullat për sjelljen në shkollë (kodeski etik), rrjedhje e rregullt e të gjitha informacioneve relevante si dhe pjesëmarrje aktive e arsimtarëve dhe nxënësve (dhe prindërit ose kujdestarët e tyre) në vendim-marrjen në shkollë. Udhëheqësia, nxit dhe mundëson shkallë të lartë të bashkëpunimit ndërmjet arsimtarëve nëpërmjet aktiveve profesionale dhe promovon pjesëmarrje aktive në organet e shkollës , ku edhe sillen vendimet. Njëkohësisht, udhëheqësia, arsimtarët dhe shërbimet profesionale, në mënyrë aktive janë të angazhuar në përkrahjen për formimin e organeve shkollore të nxënësve, në mënyrë e cila garanton participimin demokratik të nxënësve në sigurimin e të drejtave dhe lirive të tyre, në sjelljen e vendimeve për çështje, që janë në interes të tyre dhe në zgjidhjen e problemeve, të cilat i tangojnë vetë nxënësit,,.

### Koncepti për aktivitetet jashtëmësimore në arsimin fillor<sup>2</sup>

Në kuadër të këtij koncepti është parashikuar Parimi numër 4, i cili thotë: “Aktivitetet jashtëmësimore sigurojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve”. Sipas këtij parimi, pjesëmarrja aktive e nxënësve është e nevojshme në procesin e planifikimit, përzgjedhjes, zbatimit dhe monitorimit të suksesit të aktiviteteve jashtëmësimor. Gjithashtu, në kuadër të këtij koncepti, parashikohet edhe formimi i organeve të nxënësve (bashkësia e klasës, parlamenteti i nxënësve etj.) si organe përfaqësuese dhe mbrojtëse të interesave të nxënësve.

1 <https://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20MK.pdf>

2 <https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2020/06/Koncepcija-za-vonnastavni-aktivnosti-2020-1.pdf>



## 2. Koncepti pjesëmarrje e nxënësve

### 2.1 Definimi i kuptimit

#### Çka nënkupton pjesëmarrja e nxënësve?

Sipas nenit 12 nga Konventa për të drejtat e fëmijëve, fëmijët kanë të drejtë që lirshëm ta shprehin mendimin e tyre dhe të njejtës t'i kushtohet kujdes, varrësisht nga pjekuria-mosha e tyre. Në bazë të nenit 15, fëmijët kanë të drejtë në shoqërim dhe lirinë e tubimeve paqësore. Kjo, jo vetëm që u jep atyre të drejtën, por edhe i detyron shkollat që t'i mësojnë nxënësit për një udhëheqje demokratike, në atë mënyrë, duke ofruar forma të organizuara të përfshirjes aktive të nxënësve në proceset demokratike.

Shkolla, që të sigurojë pjesëmarrje aktive të nxënësve, është e nevojshme që atyre t'ju ofrojë:

- **atmosferë dhe kushte**, të cilat do t'i motivojnë dhe atimulojnë nxënësit që të formojnë mendim të tyre personal për çështje të rëndësishme nga përditshmëria shkollore dhe lirshëm të shprehin mendimin e tyre pa pasur pasojë në prapavijë;
- **mekanizma dhe procedura**, të cilat do t'ju mundësojnë nxënësve të marrin pjesë me fakte në vendim-marrje dhe të ndikojnë mbi vendimet dhe ndodhitë në shkollë, të cilat më pas do të rezultojnë në efekte të duhura nga ato ndikime.

Në bazë të praktikës dhe jetës dinamike në shkollë, pjesëmarrja e nxënësve ndodhën në më shumë lëmi, prej të cilave më kyçe janë:

Mësimi	Aktivitetet jashtëmësimre	Raporti ndërmjet nxënësve	Raporti me të rriturit	Kushtet fizike në shkollë
<ul style="list-style-type: none"><li>• Orari i orëve mësimore</li><li>• Notimi dhe sukcesi</li><li>• Plani dhe programi mësimor</li><li>• Metodrat e mësimimit</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Ekskurzione</li><li>• Shëtitje</li><li>• Manifestime</li><li>• Punëtori</li><li>• Sekcione</li><li>• Gara</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Zgjidhja e konflikteve</li><li>• Bashkëpunimi me paralelen</li><li>• Raportet me klasat më të larta</li><li>• Raportet ndërmjet nxënësve nga etnitetet të ndryshme</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Raporti arsimtar -nxënës</li><li>• Propozime nga Këshilli i shkollës</li><li>• Propozime nga Këshilli i arsimtarëve</li><li>• Propozime nga Këshilli i prindërve</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Higjiena nëpër klasë dhe nyjet sanitare</li><li>• Hapësirë dhe kushte për punë</li><li>• Pajisja e kabinetëve</li><li>• Pasurimi i bibliotekës</li></ul>

Që të spjegohet koncepti i pjesëmarrjes në sjelljen e vendimeve dhe përgjithësisht të afirmohet puna e ekipore, mundet që të shfrytëzohet ushtrimi vijues me një grup nxënësish:

### Ushtrimi: Të humburit në det

Gjendeni në një anije, e cila ka pësuar aksident dhe e kakapluar zjarri. Keni kohë që të merrni vetëm se 4 gjëra nga lista e poshtëshënuar me 10 gjëra, të cilat nuk janë përfshirë në zjarr. Pas zjarrit, paramendoni se kanë ngelur drunj, të cilët notojnë në sipërfaqe të ujit. Në horizont nuk duket tokë, as njerëz të tjerë, as edhe anije. Nuk e dini se ku jeni dhe sa kohë duhet të notoni deri në breg ose deri sa nuk nuk ju gjen ndonjë ekip i shpëtimit.

Detyrë e juaj është që nga 10 gjërat e poshtëshënuara, që janë në anije, të zgjidhni vetëmse 4 prej tyre, të cilat mendoni ju se janë më se të nevojshme si dhe të njejtat t'i rangoni prej më të domostoshmes deri tek ajo më pak e domostoshme.

Një litar shumë i gjatë
Shkrepsë
Ujë i freskët
Korpë me ushqim
Bombolë me vaj / benzin / naftë
Rrjetë për mbrojtje nga mickonjat
Radio
Shkop për peshkim, me pe najlloni dhe grep
Pasqyrë
Gomë / jastëk për shpëtim

Përgjigja e saktë:

1. Shkrepsë
2. Bombolë me vaj/benzinë/naftë
3. Ujë i freskët
4. Pasqyrë

Që të realizohet ky ushtrim, është mirë që nxënësit t'i ndani në disa grupe, me qëllim që të kenë sa më shumë përgjigje të ndryshme, të cilat do t'i diskutoni dhe më pas, t'i krahasoni me përgjigjet e sakta.



## 2.2 Shkalla e pjesëmarrjes

Shkalla e pjesëmarrjes [shtë një vegël, nëpërmjet të së cilës përcaktohet shkalla e pjesëmarrjes së nxënësve dhe fëmijëve në sjelljen e vendimeve në jetën shoqërore. Shkallën e pjesëmarrjes për herë të parë e prezntoi Roxher Hart në vitin 2008, ndërsa ajo është e zbatueshme jo vetëm se për notë dhe pozicionimin e shkallës së pjesëmarrjes së nxënësve nëpër shkolla, por edhe nëpër komunat, nëpër institucionet dhe në format e tjera të shoqërimit dhe jetesës së përbashkët. Përveç se këtij qëllimi, shkalla e pjesëmarrjes ka për qëllim edhe të bën spjegimin e raporteve të fuqive ndërmjet fëmijëve dhe të rriturve, posaçërisht sasinë e fuqisë së të rriturve, të cilët u japin dhe e drejtojnë drejt fëmijëve dhe të rinjve në proceset e sjelljes së vendimeve. Shkalla e pjesëmarrjes ka gjithsejt 8 nivele/shkallë, ku secili nivel, paraqet një sasi të vërtetuar të fuqisë, e cila jepet nga të rriturit për të rinjtë.

### Niveli 8 – Sjellja e vendimeve në mënyrë të përbashkët

Forma më e lartë e vendimmarrjes të përbashkët, ku vendimet janë të inicuar nga ana e vetë fëmijëve dhe të rinjve të ndara me të rriturit. Karakteristikë e këtij lloji të pjesëmarrjes është se mund të përforcon të rinjtë që në mënyrë aktive të ndikojnë mbi politikën dhe proceset, të cilat i tangojnë ata por, që udhëhiqen dhe kontrollohen nga të rriturit.

### Niveli 7 – Të rinjtë si drejtues dhe iniciatorë

Kjo lloj pjesëmarrjes ndodh kur të rinjtë japin një iniciativë, të cilën të rriturit e pranojnë, por vendimmarrjen e drejtojnë të rinjtë. Në praktikë, të rriturit rrallë i përgjigjen iniciativës së të rinjve, por ka shembuj pozitivë të këtij lloji të pjesëmarrjes në të cilat projektet dhe aktivitetet planifikohen dhe konceptohen bashkërisht.

### Niveli 6 – Sjellja e përbashkët e vendimeve për iniciativat e të rriturve

Ky lloj i pjesëmarrjes paraqitet atëherë kur të rriturit inicojnë projekte dhe aktivitete, por e ndajnë vendimmarrjen dhe udhëheqësinë me të rinjtë. Në disa raste, roli i të rriturve pas iniciimit, kalon në përkrahje teknike, këshilluese dhe logjistike.

### Niveli 5 – Të rinj të konsultuar dhe informuar

Ky lloj i pjesëmarrjes nënkupton se, të rriturit i konsultojnë të rinjtë në sjelljen e vendimeve dhe në realizimin e aktiviteteve, të cilat i tangojnë ato. Mendimet e tyre merren parasysh me seriozitet para sjelljes së vendimeve përfundimtare.

### Niveli 4 – Rinia e emëruar dhe e informuar

Në këtë lloj të pjesëmarrjes, të rinjtë i kuptojnë qëllimet e një projekti, e kuptojnë rolin e tyre në atë projekt dhe dinë se kush merr vendime, kanë një rol funksional dhe jo dekorativ dhe mund të përfshihen në realizimin e projektit.

### Niveli 3 – Tokenizmi (mospjesëmarrja)

Ky nivel demonstroi mospjesëmarrje sepse paraqet situata, në të cilat fëmijëve u jepet sipërfaqësisht e drejta për të votuar, por në realitet, ata as nuk mund të zgjedhin se si të shprehin mendimin e tyre dhe as nuk kanë mundësi për të formuluar mendimin e tyre të drejtë.

### Niveli 2 – Dekorimi (mospjesëmarrja)

Ky nivel demonstroi mospjesëmarrje dhe lidhet me situatat, në të cilat fëmijët dhe të rinjtë vendosen në një vend publik, në një ngjarje, manifestim ose proces, por ata as nuk janë të informuar për qëllimin dhe as nuk e kuptojnë rolin e tyre në ngjarjen dhe projektin.

### Niveli 1 – Manipulimi (mospjesëmarrja)

Ky nivel demonstroi mospjesëmarrje dhe situata, në të cilat të rinjtë as nuk janë të njohur me pyetjet që i tangojnë ato, as edhe nuk e kuptojnë rolin e tyre në proces dhe nevojën për të qenë pjesëmarrës.

## 2.3 Palët e kyçura në proceset e pjesëmarrjes së nxënësve

Në proceset e vendimmarrjes dhe sigurisht në realizimin e aktiviteteve dhe projekteve që tangojnë të rinjtë dhe kanë të bëjnë me zgjidhjen e çështjeve që janë të rëndësishme për ta, shfaqen palë të ndryshme të interesuara - individë dhe grupe. Në varësi të projektit ose aktivitetit, palët e interesuara mund të jenë të ndryshëm. Për më tepër, varësisht nga konteksti në të cilin realizohen aktivitetet, gjegjësisht merren vendimet, mund të dallohen palët e interesuara në nivele të ndryshme lokale dhe nacionale.


Pa marrë parasysh nëse projekti ose aktiviteti është iniciuar nga të rriturit ose është një iniciativë e të rinjve/nxënësve ose një projekt i një organizate rinore, fëmijët dhe të rinjtë duhet të dinë se kush mund të përfshihet. Për atë arsye, është më mirë të përgatitet një listë e palëve të kyçura, mbi bazën e së cilës fëmijët dhe të rinjtë mund të analizojnë dhe kuptojnë me kujdes rolet e të gjitha palëve të interesuara. Gjithashtu, në situatat ku janë të përfshira disa palë, shqyrtimi i të gjithave u mundëson fëmijëve dhe të rinjve të përcaktojnë në mënyrë më të përshtatshme qëndrimin e tyre, gjegjësisht të mbajnë qëndrim për vendimin që do të merret.

Gjatë përgaditjes së listës me palët e përfshira, fëmijët dhe të rinjtë mund të kërkojnë ndihmë nga mësuesit dhe/ose nga prindërit, të cilët e njohin kontekstin dhe fushën e punës në të cilën realizohet aktiviteti ose projekti. Si elemente kyçe në listën e palëve të përfshira mund të jenë:

- Emri i palës së përfshirë
- Lokaliteti ku gjendet, adresa dhe vendi i banimit
- Kontaktet si telefon, person-kontakti, e- mail, web-fleta, profili në rrjetet sociale
- Përshkrim i shkurtër për përgjegjësinë e palës së kyçur – për çka ajo palë është përgjegjëse dhe e angazhuar
- Roli i palës së përfshirë në aktivitet ose projekt, gjegjësisht, qëndrimi dhe pozicioni në lidhje me një vendim, i cili duhet të merret.

Në vazhdim është dhënë një pasqyrë e palëve potenciale të përfshira në situata të ndryshme.


### Situata 1: Në shkollë





Jo çdo herë, të gjitha palët përfshihen në të gjitha aktivitetet apo vendimet që merren në shkollë. Për shembull, ndonjëherë kur vjen puna për të vendosur nëse do të prezantohet një gazetë shkollore apo ndoshta një radio për nxënësit, në këtë vendim prindërit rrallë përfshihen. Nga ana tjetër, ka edhe vendime apo aktivitete që janë të një karakteri më të vogël dhe që mund të mos përfshijnë as edhe udhëheqësinë e shkollës. Këto janë ato aktivitete, që kryhen në nivel klase - për shembull, kur mësuesit i kërkojnë të shtyjë testimin ose pyetjet për nxënësit.


### Situata 2: Në komunë dhe institucionet lokale



Kur bëhet fjalë për situatat e sjelljes së vendimeve ose aktiviteteve në komunë dhe në institucionet lokale spektri i palëve të përfshira është pak sa i ndryshëm. Kështu për shembull, nëse duhet që të organizohet një manifestim për nder të ditës së të rinjve, por që është inicuar nga komuna ose institucionet kulturore lokale, në atë rast, si palë kryesore të kyçura do të paraqiten fëmijët dhe të rinjtë, Kryetari i komunës dhe të punësuarit në shërbimet komunale, si dhe udhëheqësia dhe të punësuarit e institucioneve kulturore.

### Situata 3: Në institucionet nacionale – shembull: Avokati i popullit

Përfshirja në aktivitetet e iniciuara nga institucionet kombëtare bëhet kryesisht me iniciativën e shkollave, organizatave të shoqërisë civile ose vetë institucioneve nacionale. Shembull i tillë për shembull, mund të jenë manifestimet dhe aktivitetet me rastin e Ditës së Fëmijëve, ku fëmijët dhe të rinjtë vizitojnë institucione të rëndësishme nacionale siç janë Parlamenti, Qeveria, Avokati i Popullit dhe marrin pjesë në punën e tyre, dërgojnë mesazhe, zhvillojnë debate dhe diskutime etj.



## ***Ushtrim: Përgaditja e Listës së palëve të përfshira - tanguara***

Ky ushtrim ka për qëllim që të lehtësojë identifikimin e palëve të tanguara, të cilat palë janë përfshirë në realizimin e ndonjë aktiviteti, i cili planifikohet përmes bashkësisë së paraleles ose në nivel të Parlamentit të nxënësve.

Përgaditja: Përgaditni fleta, ku në to paraprakisht e keni përshkruar aktivitetin, të cilin e planifikoni. Përshkrimi duhet të jetë në formë të një teksti të shkurtër. Nxënësve j'ua shpërndani fletët, që të mundën të lexojnë dhe të kuptojnë aktivitetin dhe të parashtrojnë ndonjë pyetje që t'a kenë më të qartë.

**Hapi 1** – Ndani të gjithë nxënësit në 4 – 5 grupe me nga 5 – 6 nxënës. Secilit grup i jepni flip-çart letër dhe markerë për të shkruar.

**Hapi 2** – Secilit grup i jepni se, cilin lloj të palëve të tanguara duhet të identifikojnë, si psh: përfaqësues nga shkolla, përfaqësues nga Komuna, prindërit e të ngjajshme.

**Hapi 3** – Secili grup, varësisht nga detyra e përcaktuar, nevojitet që me anë të vizatimit t'i paraqet palët, të cilat do t'i identifikojë. Dhe, për secilën palë të identifikuar, duhet të theksohen të gjitha të dhënat nëpërmjet të cilave përshkruhet, dmth, të dhënat, të cilat janë shkruar më lartë, në tekstin për palët e interesuara-tanguara. Gjithashtu, grupi në flip-çart, duhet të shkruan se cilat aktivitete duhet që të ndërmerren për kyçjen e palëve të interesuara në aktivitetin, i cili do të planifikohet.


**Hapi 4** – Secili grup, në fund, bën edhe prezentimit e punës së tyre para grupeve të tjera dhe duke diskutuar dhe plotësuar, kompletohen të gjitha grupet e palëve të interesuara, me të cilat duhet që të komunikohet dhe që të njëjtët duhet të kyçen në aktivitet.

Arsimtari, gjithashtu merr pjesë në diskutimin dhe kompletimin e informacioneve për palët e interesuara.

Në fund të ushtrimit. Të gjitha flip-çartet ngjiten/vihen në vend të dukshëm, ku edhe do të vazhdohet më tej me planifikimin e aktiviteteve.

## **2.4 Standardet e pjesëmarrjes së nxënësve**

Në proceset e sigurimit të pjesëmarrjes së nxënësve, fëmijët dhe të rinjtë si dhe të rriturit duhet të udhëhiqen nga disa rregulla dhe standarde sipas të cilave arrihet një cilësi e caktuar në proceset e pjesëmarrjes. Këto standarde vendosen më shumë në nivel operacional, gjegjësisht për të siguruar pjesëmarrje cilësore në situatat e përditshme në shkollë, dhe më gjerë në komunitetin lokal dhe institucionet kombëtare. Ato bazohen në drejtësi dhe etikë si dhe veprojnë në përputhje me interesin më të mirë të fëmijëve.



## 1. Transparenca dhe ndershmëria- ky standard është sjellur me qëllim që të balansojë fuqinë e proceseve, në të cilat procese janë të kyçur fëmijët

Me këtë standard sigurohet hapja e të rriturve kundrejt fëmijëve në proceset e pjesëmarrjes së fëmijëve. Nga të rriturit pritet që të ndajnë me kohë informata të sakta dhe precize për të gjitha aspektet e pyetjeve që shqyrtohen, të njihen me të gjitha palët e kyçura, prezentimi i kjarët i rolit të palëve të kyçura, dhënia e përkrahjes dhe ndihmës fëmijëve dhe të rinjve që të kuptojnë pozicionin dhe rolin e palëve të interesuara dhe pozicionin e tyre.

## 2. Pjesëmarrja vullnetare dhe relevante – me këtë standard sigurohet pjesëmarrja e fëmijëve që ata e dëshirojnë dhe që ka kuptim dhe rëndësi

Me këtë standard sigurohet pjesëmarrja vullnetare nga ana e fëmijëve, gjegjësisht, kjo do të thotë që fëmijët janë të kyçur në proceset e sjelljes së vendimeve si dhe në aktivitete dhe projekte të ndryshme, në bazë vullnetare dhe me kërkesë vetanake, pa u detyruar nga tjerët. Në mënyrë plotësuese, në bazë të këtij standardi, pjesëmarrja e fëmijëve nxitet dhe realizohet në të gjitha situatat ku është e nevojshme dhe e domosdoshme edhe tek pyetjet, të cilat në mënyrë direkte i tangojnë ato, por jo edhe në situata kur qëndrimi i fëmijëve nuk është relevant. Gjithashtu, pjesëmarrje relevante nënkupton se, fëmijët i kanë të gjitha informatat dhe njohuritë e nevojshme që të mundën në mënyrë përkatëse të marrin pjesë në proceset e sjelljes së vendimeve dhe nëpër aktivitete.

## 3. Mjedis miqësor dhe inkurajues – me këtë standard sigurohet mjedisi, në të cilin ndodh pjesëmarrja e nxënësve dhe që të jetë mjaftueshëm nxitëse dhe motivuese për fëmijët dhe të rinjtë

Me këtë standard, sigurohet mjedisi për të punuar me fëmijët dhe të rinjtë, në të cilin ata do të ndihen rehat, të inkurajuar dhe të motivuar. Mjedisi i tillë, nënkupton shpërndarjen në kohë të informacionit, përshtatjen e rregullave dhe kushteve për punë me nevojat dhe moshën e fëmijëve, sensibilizimin e të rriturve ndaj nevojave të ndryshme kulturore, gjuhësore dhe sociale të fëmijëve dhe të rinjve. Mjedisi, në të cilin punohet me fëmijët dhe të rinjtë, fëmijët dhe të rinjtë ofron ndihmë dhe mbështetje adekuatë në mënyrë që ata të kuptojnë më mirë detyrat e tyre, por edhe veprimet e të rriturve si parakusht për ndërtimin e besimit të ndërsjellë.

## 4. Barazia e mundësive – me këtë standard sigurohet mundësia që të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, në mënyrë të barabartë të marrin pjesë në proceset e pjesëmarrjes dhe sjelljes së vendimeve

Fëmijët dhe të rinjtë, nuk janë grup homogjen dhe m'u për këtë, në proceset e pjesëmarrjes, kjo njohuri duhet që të merret parasysh. Pjesëmarrja duhet të jetë e arritshme për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pa marrë parasysh statusin e tyre, gjininë, moshën, gjuhën, ngjyrën e lëkurës, religjionin, etj. Pjesëmarrja duhet të jetë një mundësi, që sa më shumë fëmijë dhe të rinj dhe jo pak, që tashmë kanë avantazhin dhe mundësitë për t'u përfshirë në proceset vendimmarrëse.

## 5. Të rriturit marrin pjesë në mënyrë efikase dhe të sigurtë – me këtë standard sigurohet pjesëmarrja nga ana e të rriturve që të jetë e përshtatshme për nevojat e fëmijëve dhe proceseve

Pjesëmarrja e fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete dhe në sjelljen e vendimeve, mund të jetë e dobishme, vetëm se nëse të rriturit janë trajnuar dhe përgatitur siç duhet për t'u pozicionuar në ato procese, me të vetmin qëllim që të mbështesin fëmijët dhe të rinjtë. Për këtë qëllim, të rriturit duhet të marrin trajnimin e duhur, nëpërmjet të cilit do të mësojnë metoda dhe teknika të ndryshme të komunikimit me fëmijët dhe të rinjtë, në mënyrë që të kenë një proces efektiv dhe të suksesshëm. Ata duhet të zbatojnë aftësitë e fituara në punën me fëmijët, në mënyrë që t'u ofrojnë atyre hapësirë për t'u shprehur dhe për të realizuar idetë dhe bindjet e tyre.

## 6. Siguria dhe mbrojtja e fëmijëve - me këtë standard sigurohet ajo që fëmijët të jenë të sigurtë dhe të mbrojtur në proceset e pjesëmarrjes

Jo shpesh, nga frika e abuzimit për pjesëmarrje të fëmijëve në situata të ndryshme, mund të arrihet deri tek keqpërdorimi, anashkalimi dhe maltretimi i fëmijëve. Për këtë qëllim, që t'u largohemi situatave të tilla, bartësit e aktiviteteve siç janë institucionet lokale dhe nacionale, komuna dhe shkollat, është e nevojshme që të përgadisnin dhe përdorin një politikë të veçantë, mekanizma dhe procedura për mbrojtjen e fëmijëve në situata nga më të ndryshmet. Mekanizmat dhe procedurat e tilla, duhet të jenë të njohura dhe të pranuar nga ana e të rriturve.

## 7. Kontrollimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm - me këtë standard sigurohet informata kthyesë deri tek fëmijët, për sukseset e proceseve dhe ndikimi, të cilin e kanë arritur

Me këtë standard sigurohet informatë kthyesë në vazhdimësi mbi të arriturat nga proceset e sjelljes së vendimeve dhe aktiviteteve edhe atë veçmas, deri tek secili fëmijë, që ka qenë i kyçur në proces. Në atë mënyrë, sigurohet kyçja e fëmijëve nëpër të gjitha fazat e një procesidhe gjithashtu, fëmijët janë të vetëdijshëm dhe çdo herë të informuar për rezultatet nga pjesëmarrja dhe për ndikimin, të cilin e kanë pasur përmes kyçjes së tyre.

### 2.5 Modele të pjesëmarrjes së nxënësve


Në bazë të Ligjit për arsim fillor, neni 68anë parashikuar disa modele të pjesëmarrjes së nxënësve edhe atë:

- Bashkësia e paraleles
- Parlamenti i nxënësve ( si bashkësi në nivel të shkollës )
- Avokati popullor i nxënësve

Në këtë pjesë të Dorracakut, do të përpunohen modelet e bashkësisë së paraleles dhe avokatit popullor të nxënësve, ndërsa më tej, theks të veçantë do t'i vihet Parlamentit të nxënësve.


## Bashkësia e paraleles

Nxënësit kanë të drejtë që të organizohen në nivel të paraleles. Bashkësinë e paraleles e përbëjnë të gjithë nxënësit e paraleles (klasës). Detyrat e bashkësisë së paraleles janë që të vendosin për pyetje lidhur me procesin e mësimin, qëndrimin në shkollë, raportet e ndërsjella si dhe, raportet ndërmjet personave të rritur në shkollë dhe funksionet e poshtëshënuara:

-  Kryetari
-  Zëvendës - kryetari
-  Organet e përhershme
-  Organet e përkohshme

Kryetari i bashkësisë ka detyra shumë të rëndësishme sepse vetë ai është përfaqësues i tërë nxënësve nga paralelja e tij në shkollë. Detyrat e tij janë:

- » T'i përfaqësojë nxënësit e klasës së tij në Parlamentin e nxënësve dhe para të gjitha organeve tjera në shkollë;
- » Në vazhdimësi t'i informojë të gjithë nxënësit e paraleles për punët, për të cilat diskutohet në Parlamentin e nxënësve;
- » Të organizon debate dhe diskutime në klasë për pyetje dhe probleme konkrete ( me vetëinicijativë ose me inicijativë nga të tjerët), siç janë për shembull: problemet në procesin mësimor, probleme në kominukimin e ndërsjellë ndërmjet nxënësve dhe arsimtarëve, kualiteti i vlerësimit së njohurive të nxënësve, kualiteti i mësimin, problem konkret me ndonjë mësimdhënës, etj;
- » Në bazë të kërkesës dhe nevojave të udhëheqësit të paraleles, duhet të merr pjesë në mbledhjet prindore, me mundësinë që të shpjegojë perspektivat e nxënësve për punët për të cilat edhe bisedohet;
- » Të kujdeset për zgjidhjen e drejtë të konflikteve ndërmjet nxënësve në paralele;
- » Të bashkëpunon me të gjithë kryetarët e tjerë ta paraleleve dhe me të gjitha organet tjera të përhershme dhe të përkohshme, të cilat do të formohen;
- » Të inicon dhe/ose të organizon zgjedhjene e organeve të përhershme dhe të përkohshme edhe në bazë të propozimeve nga nxënësit e paraleles



Duhet të dihet se, **mënyra e zgjedhjes së Kryetarit dhe Ndhmës-kryetarit** është një proces shumë i rëndësishëm dhe i vlefshëm për nxënësit e paraleles. I njëjti duhet të jetë i organizuar duke përdorur principin e pjesëmarrjes së të gjithë nxënësve në këtë proces, një mundësi kjo, për zgjedhje demokratike dhe për një vendim-marrje tëpavarur nga ana e nxënësve. Roli i arsimtarit, kujdestarit të klasës, është shumë e rëndësishme, parasëgjithash, për tëpërkrahur procesin, t'a udhëheq procesin dhe të ndihmojë nxënësit që të njëjtin t'a realizojnë në mënyrë transparente dhe inkluzive. Si rekomandime për të pasur sukses në zgjedhje të Kryetarit të bashkësisë së klasës dhe zëvendës-kryetarit, janë si më posht:

- » Arsimtari - kujdestari i klasës t'i informon të gjithë nxënësit për rëndësinë e zgjedhjeve;
- » Arsimtari duhet që t'u shpjegon nxënësve për rolin e Kryetarit dhe zëvendës kryetarit;
- » Nxënësit t'a mendojnë procesin e votimit nëpërmjet paraqitjes së kandidatëve, sigurimi i përkrages nga shokët e klasës si dhe prezentimi e motivimi i kandidatëve me një letër motivuese;
- » Arsimtari t'i siguron resurset e nevojshme siç janë: letra, shkumësa, markerë, kutija e votimit, etj.
- » Arsimtari tëkujdeset për rrjedhën dhe objektivitetin e zgjedhjeve.

Publikimi "Udhëzues për pjesëmarrjen e nxënësve, organizimin e nxënësve dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shkollat fillore<sup>3</sup>" i botuar nga Koalicioni i Organizatave Rinore SEGA në bashkëpunim me Byronë për zhvillimin e arsimit dhe Fondacionin e Fëmijëve Pestalozzi përmban udhëzime të sakta se si zhvillohet procesi zgjedhor. Gjithashtu, në Udhëzues mund të gjeni disa këshilla praktike për të siguruar përfaqësim të barabartë gjinor në përzgjedhje, si dhe përfshirje të duhur të të gjithë nxënësve në organet e përhershme dhe të përkohshme.

Vendimin se, cilat organe të përhershme dhe të përkohshme do të formohen, e marrin të gjithë nxënësit dhe ata duhet të diskutojnë dhe të pajtohen se, cilat janë nevojat e tyre. Për nga natyra, organet e përhershme formohen për çështje që kanë rëndësi të vazhdueshme në çdo vit shkollor, si: organizimi i ekskursioneve, aksioneve mjedisore, aktiviteteteve humanitare etj. Organet e përkohshme formohen për të zgjidhur çështjet që lindin herë pas here ose papritur gjatë shkollimit. Organe të tillë mund të formohen për: festimin e maturës, punimin e tablosë, mbajtjen e uniformave etj.

## Avokati i popullit të nxënësve - Ombucmani

Avokati i Popullit i nxënësve, është një funksion dhe detyrë e nxënësve, i cili paraqet një model të ri të pjesëmarrjes së nxënësve ,mjaft i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shkollë. Për të siguruar përfshirje më të madhe në paralele të ndryshme, rekomandohet që, përveç Avokatit të Popullit të nxënësve të zgjidhen edhe (së paku) dy zëvendës të tij. Avokati i popullit nxënësve zgjidhet për të kryer dy funksionet kryesore si më poshtë:

- » T'i promovojë të drejtat e fëmijëve në shkollë;
- » Të jeppërkrahje në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Avokati i popullit i nxënësve, detyrat e tiji kryen në bashkëpunim të ngushtë me shërbimin pedagogjik-psikologjik në shkollë, i cili e ndihmon që ai/ajo të zhvillojë punëtori, fushata informuese dhe prezantime, përmes të cilave do të ndihmojë shokët e klasës të mësojnë më shumë rreth të drejtave të tyre. Gjithashtu, mbështetja e shërbimit profesional është veçanërisht e rëndësishme në situatat kur Avokati i Popullit merr një parashtrësë apo raport nga një shok klase se, e drejta e tij/saj është rrezikuar apo shkelur.

Avokati i studentëve zgjidhet nëpërmjet thirrjes publike. Thirrjen publike e përgadisin përfaqësuesit e shërbimit profesional. Të drejtë paraqitjeje kanë nxënësit e klasës së shtatë, tetë dhe të nëntë. Mandati i Avokatit popullor të nxënësve është 2 vjet. Zgjedhja bëhet me votim të fshehtë nga nxënësit e klasës së shtatë, tetë dhe të nëntë. Më shumë informacion për mënyrën dhe procedurën e zgjedhjes së Avokatit të nxënësve mund të gjeni në publikimin “Udhëzues për pjesëmarrjen e nxënësve, organizimin e nxënësve dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shkollat fillore”.

Për modelet e przentuara të pjesëmarrjes, me rëndësi është që ato të jenë funksionale dhe të kryejnë detyrën për të cilën janë zgjedhur. Për këtë qëllim është e nevojshme të përgatitet një Program pune si nga Bashkësia e klasës poashtu edhe nga Avokati popullor i nxënësve, i cili program do të realizohet gjatë vitit shkollor. Si Kryetari i klasës ashtu edhe Avokati i popullit të nxënësve duhet të thirren dhe të mbajnë takime të rregullta me nxënësit dhe të marrin pjesë në mbledhjet e rregullta të Parlamentit të nxënësve.

## 3. Krijimi i Parlamentit të nxënësve

### 3.1 Kuptimi për Parlamentin e nxënësve

#### Çka është Parlamenti i nxënësve?

Parlamenti i nxënësve është organ përfaqësues i nxënësve në shkollë. Nëpërmjet Parlamentit të nxënësve, paraqiten interesat e nxënësve në proceset e sjelljes së vendimeve lidhur me pyetjet, të cilat i tangojnë në mënyrë direkte nxënësit në shkollë.

Me Ligjin për Arsimin Fillor të miratuar në korrik 2019, Parlamenti i nxënësve është rregulluar si organ përfaqësues i nxënësve në shkollat fillore së bashku me format e tjera të pjesëmarrjes së nxënësve.

Parlamentin e nxënësve e përbëjnë Kryetarët e zgjedhur të Bashkësive të klasave të shkollës. Me Parlamentin e nxënësve udhëheq Kryetari i zgjedhur i Parlamentit të nxënësve. Në kapitullin e parë të këtij dorracaku, është përpunuar roli i Parlamentit të nxënësve, ashtu siç është

përcaktuar në Ligjin për arsimin fillor, prandaj që në këtë pjesë do të rikujtojmë shkurtimisht funksionin themelor të Parlamentit të nxënësve, i cili konsiston në përfaqësimin e kërkesave dhe interesave të nxënësve para organeve shkollore, në lëmitë, të cilat janë të rëndësishme për nxënësit si mësimdhënia, aktivitetet jashtëmësimore, kushtet e punës në shkollë etj. Më konkretisht, Parlamenti i nxënësve nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, merr pjesë në punën e Këshillit të shkollës si dhe në punën e Këshillit të mësimdhënësve me qëllim të paraqitjes së kërkesave të nxënësve.

## 3.2 Hapat në përfaqësimin e Parlamentit të nxënësve

### Hapi 1 – Konstituimi

Parlamenti i nxënësve formohet në **mbledhje konstituive**. Këtë mbledhje, në bazë të Ligjit për arsimin fillor, e thërret drejtori i shkollës, në fund të muajit shtator, kur edhe ka filluar më procesi i zgjedhjes së Kryetarëve të paraleleve. Me vetë thirrjen, në të vërtetë bëhet edhe konstituimi i parlamentit.

### Hapi 2 – Zgjedhja e Kryetarit të Parlamentit të nxënësve


Në mbledhjen konstituive **zgjedhet Kryetari i Parlamentit të nxënësve**. Për atë qëllim, para se të fillojë mbledhja, deri tek Drejtori i shkollës ofrohen kandidaturat, nga ato kryetarë, të cilët kanë dëshirë që të konkurojnë për këtë post. Nga Kryetarët tjerë, të cilët nuk janë kandiduar, formohet një komision, i cili do të realizojë zgjedhjet. Kandidatët për kryetar, prezentohen para Parlamentit të nxënësve dhe tregojnë motivacionin e tyre dhe idetë e tyre, në interes të përfaqësimit të interesave të nxënësve. Zgjedhja vazhdon me mënyrë të votimit (e cila bëhet në mënyrë të fshehtë) dhe pas numërimit të votave nga ana e komisionit, i njejtë komision bën edhe prezentimin e rezultateve. Për Kryetar zgjedhet ai kandidat, i cili ka marrë numër më të madh votash, ku në mbledhje patjetër që duhet të jenë prezentë më së paku 2/3 e anëtarëve të Parlamentit të nxënësve.

### Hapi 3 – Zgjedhja e organeve të tjera dhe organeve të Parlamentit të nxënësve

Krahas zgjedhjes së Kryetarit të Parlamentit të nxënësve, zgjedhet edhe **Ndihmës-kryetari** dhe **Sekretari**, të cilët i ndihmojnë Kryetarit në kryerjen e funksionit të tij. Me qëllim që më lehtë të koordinohen aktivitetet nëpër klasë, nga Parlamenti i nxënësve zgjedhen **Koordinatorë të klasave**. Gjithashtu, Parlamenti i nxënësve duhet të formon edhe Organin koordinues i përbërë nga Koordinatorët e klasëve, dy përfaqësues nga rradhët e arsimtarëve, të cilët i përcakton paraprakisht drejtori i shkollës, dhe Sekretari i Parlamentit të nxënësve.



## Procesi i konstituimit dhe funksionaliteti i Parlamentit të nxënësve






### 3.3 Funksionaliteti i Parlamentit të nxënësve

#### Programi për punë

Organi koordinues i formuar në kuadër të Parlamentit të nxënësve, përpilon draft-programë për punë. Përgaditja e programës rekomandohet të bëhet nëpërmjet **qasjes inkluzive** ku, secili nxënës do të ketë mundësi t'i paraqesë idetë dhe mendimet e veta rreth programës për punë të Parlamentit të nxënësve. Në atë kontekst, Organi koordinues mund të shfrytëzojë disa nga metodat vijuese që të sigurojë pjesëmarrje të nxënësve:





- 🎯 Të organizon këshillime nëpërmjet coordinatorëve të paraleleve;
- 🎯 Të hap thirrje publike për paraqitjen e ideve deri tek Trupi koordinativ;

-  Të organizon debat publik me gjithë nxënësit, ku do të flasin për propozimet;
-  Të përgadit draft-program, të cilëan do t'a paraqes në debat dhe diskutim me nxënësit;
-  Të realizon anketë për zgjedhjen e aktiviteteve të caktuara në programin e punës, etj.

Në bazë të informatave tëpërfituara, Organi koordinues, përgadit Propozim programë, e cila miratohet në mbledhjen e Parlamentit të nxënësve. Si elemente në Propozim programën për punë mund të jenë:

- Pjesa hyrëse, në të cilën spjegohet qëllimi dhe kujt i dedikohet Programi;
- Pasqyra dhe skjarimi i aktiviteteve, në të cilën jepen përshkrime të shkurtra për secilin aktivitet edhe atë: qëllimi i aktivitetit, si do të realizohet dhe çka pritet pas realizimit;
- Korniza kohore për realizim të programës, në formë të një table, ku për secilin aktivitet, shënohet koha e realizimit;
- Përshkrimi i përgjegjësive, në formë table, ku për secilin aktivitet, shënohen se kush janë bartësit përgjegjës të atij aktiviteti dhe çfarë përkrahje pritet nga arsimtarët dhe nxënësit e tjerë;
- Resurset e nevojshme për realizim, si përshkrim për resurset dhe materialet e nevojshme për realizimin e aktiviteteve si dhe përshkrim të burimit të resurseve (psh. buxheti i shkollës, nga donacionet e prindërve, donacione nga bizneset e ndryshme, mjete nga komuna etj.)

## Funksionimi i Parlamentit të nxënësve

-  Parlamenti i nxënësve **punon në mbledhje**. Mbledhjet zakonisht i thirr kryetari i Parlamentit të nxënësve me shkrim. Mbledhjet mbahen në hapësira të veçanta, të cilat përcaktohen nga ana e Drejtorit të shkollës për nevojat e Parlamentit të nxënësve.
-  Mbledhjet e Parlamentit të nxënësve mund të thirren edhe me **inicijativë të Kryetarit** ose me **inicijativë të anëtarëve** të Parlamentit të nxënësve.
-  Në mbledhjet e Parlamentit të nxënësve mund të marrin pjesë edhe **nxënës të tjerë**, arsimtarë, **përfaqësues** të Këshillit të shkollës ose Këshillit të prindërve, me njoftim paraprak dhe me pëlqimin e Kryetarit të Parlamentit të Nxënësve. Pjesëmarrësit e jashtëm kanë statusin e mysafirëve pa të drejtë vote.
-  Në mbledhjet e Parlamentit të nxënësve është e nevojshme **që të vihen dhe të resektohen rregullat**. Disa nga ato rregulla mund të jenë:

- Respektimi i të drejtës në fjalë;
- Kohë të mjaftueshme që folësi t'a ketë në dispozicion që të shprehet;
- Dëgjimi i bashkëbiseduesve pa ju ndërhyrë në bisedë;
- Rregulla e marrjes së fjalës, pas ngritjes së dorës dhe pasi të jepet fjala nga Kryetari i Parlamentit të nxënësve;
- E drejta për mosshfrytëzimin e pajisjeve elektronike gjatë mbajtjes së mbledhjes.



Parlamenti i nxënësve duhet të ketë **haësirë të vetën në web faqen e shkollës** dhe profil në rrjetet sociale, të cilat do të administrohen nga një nxënës i paracaktuar. Në këtë vend do të prezentohen informata nga puna e Parlamentit të nxënësve.

## Funksionimi i Parlamentit të nxënësve në distancë

Në kohën e pandemisë, u paraqit nevoja e funksionimit të organeve të nxënësve nga distanca. Parasëgjithash, duhet të theksohet se ky segment nga jeta shkollore ishte mjaft i marginalizuar në kohën e pandemisë, sepseprioritet dhe akcent i'u vu procesit mësimor. Megjithatë, në vazhdim është mirë që të planifikohen situatat e poshtëshënuara:



**Frekuenca e mbledhjeve** – Të fillohet me mbajtjen e rregullt të mbledhjeve në distancë, të paktën dy herë në muaj;



**Propozimi i pikave për diskutim** – MS Teams, ku secili mund të propozojë tema për diskutim para mbledhjes;



**Kohëzgjatja e mbledhjeve** – Kohëzgjatja e mbledhjeve mund të përcaktohet dhe të thirret paraprakisht deri te të gjithë pjesëmarrësit. Psh, kohëzgjatje e mbledhjes të jetë prej 30 – 60 minuta;



**Rregullat e mbajtjes së mbledhjeve** – respektimi i atij që flet, ngritja e dorës për të marë fjalën, shfrytëzimi i chat-it, që të munden të paraqesin mendimet nxënësit;



**Kontrollimi i pranisë** – Të sillet një rregull, për pjesëmarrje të detyrueshme në takimet në distancë dhe kontrollimi nëpërmjet nënshkrimit në listën për pjesëmarrje. Të gjithë nxënësit, duhet të inkurajohen, që të marrin pjesë aktive në mbledhjet në distancë;



**Proçesverbali** – Paracaktohet një person që do mbajë proçesverbalin, i cili në mënyrë të shkurtër do të shënojë vërrejtjet nga mbledhjet e realizuara si dhe përfundimet e sjellura.

## 4. Shkathtësitë e përfaqësuesve në parlamentin e nxënësve

### 4.1 Shkathtësitë e komunikimit

Disa nga shkathtësitë, të cilat duhet që të zhvillojnë veçanërisht anëtarët e Parlamentit të nxënësve dhe organet e tjera përfaqësuese në shkollë, sigurisht që janë shkathtësitë e komunikimit. Në përmbushjen e rolit të tyre si përfaqësues të interesave të nxënësve, anëtarët e Parlamentit të nxënësve, shumë shpesh do t'u duhet të përcjellin, diskutojnë, paraqesin një mesazh ose qëndrim të caktuar, si dhe të marrin informata kthyesë, të cilat më tej, nevojitet t'i ndajnë me shokët e klasës. Prandaj është me rëndësi që, ata të kuptojnë se çfarë është komunikimi, çka krejt përmban ajo dhe, të mësojnë të komunikojnë pozitivisht dhe fuqishëm si me të rriturit ashtu edhe me shokët e klasës.



Komunikimi paraqet **transmetimin e një mesazhi ose informacioni** nga dërguesi te marrësi i mesazhit përmes një kanali të caktuar komunikimi. Gjithashtu, në sistemin e komunikimit përfshihen **informacionet kthyesë**, që marrësi i mesazhit e kthen pas tek dërguesi dhe që tregon shkallën, në të cilën ai e ka kuptuar mesazhin ose informacionin dhe nëse e ka kuptuar saktë. Procesi i komunikimit shpesh ndërpritet nga burime të ndryshme ndërhyrjesh, të cilat e vështirësojnë komunikimin dhe që mund të çojnë në keqkuptim nga dërguesi i mesazhit dhe marrësi. M'u për këtë arsye, informacioni kthyesë është më se i rëndësishëm si një element përfundimtar i komunikimit.



Komunikimi zhvillohet në forma:

- » **Komunikimi verbal** – ku si mjet themelor përdoret gjuha dhe të folurit;
- » **Komunikimi joverbal** – ku shkëmbimi i mesazheve bëhet nëpërmjet gjestikulacioneve, shprehjeve të fytyrës dhe gjuhës së trupit;
- » **Komunikimi elektronik** – e cilanënkupton shkëmbimin e mesazheve të shkruara në formë elektronike.

#### Komunikimi verbal

Komunikimi verbal është i mbushur me **shprehje, fraza, fjalë dhe fjali**, të cilat në procesin e komunikimit shkëmbehen ndërmjet pjesëmarrësve në komunikim. Duke pasur parasysh këtë, anëtarët e Parlamentit të nxënësve duhet të përpiqen vazhdimisht të përdorin fraza dhe shprehje, të cilat janë janë: **të sinqerta, të kuptueshme, të qarta, të shprehura saktë, që ngjallin empati, motivuese**. Të folurit, ndikohet nga kultura, tradita, zakonet, normat dhe lëvizjet shoqërore, dhe në përputhje me rrethanat formohet komunikimi verbal, i cili ndryshon nga një vend në tjetrin ose nga një grupmoshë në tjetrën. Kjo është arsyeja pse, gjatë komunikimit, duhet të merret parasysh

mosha e dërguesit ose marrësit të mesazhit, si dhe prejardhja e tij kulturore dhe etnike. Shembull i frazave të përdorura në komunikimin verbal:







- » Të lutem,
- » urdhëro,
- » nëse do të doje,
- » interesante,
- » e kam të vështirë të dakordohem.

Aspekt i veçantë i komunikimit verbal është heqja dhe **largimi i gjuhës së urrejtjes, stereotipizimit dhe fyerjes**. Një pjesë e madhe e konflikteve mes njerëzve, lindin nga përmbajtja e pamjaftueshme e komunikimit verbal dhe përdorimi i vrazhdësisë që krijon një atmosferë kërcënimi, frike dhe ndjesisë jo të sigurtë.

## Ushtrim për zhvillimin e komunikimit joverbal

Ushtrimi 1: Përcjellja e mesazhit dhe përmbajtjes

Në këtë ushtrim pjesëmarrësit mësojnë se si në mënyrë të saktë, të qartë dhe precize të përcjellin një mesazh. Ushtrimi i përmban hapat vijuese:

-  Zgjidhni ndonjë përrallë të shkurtër nga revista ose libri, për të cilën janë të nevojshme 3 – 5 minuta që të përcillet;
-  Zgjidhni një grup prej 10 pjesëmarrësve në ushtrim, ku njërit prej tyre do ja tregoni përrallën;
-  Pjesëmarrësit, të cilit i'a treguat përrallën, duhet që t'ia përcjellë të njejtën një pjesëmarrësi tjetër, ndërsa të tjerët duhet të dalin jashtë hapësirës;
-  Pjesëmarrësi i dytë duhet që t'ia përcjell pjesëmarrësit të tretë dhe ushtrimi vazhdon njejtë deri tek pjesëmarrësi i fundit;
-  Pjesëmarrësi i dhjetë duhet që me zë t'a tregojë përrallën, e cila i është përcjellur;
-  Më pas bëhet krahasimi i verzionit të parë origjinal i përrallës me verzionin e fundit të dëshuar nga pjesëmarrësi i fundit dhe më pas fillon edhe diskutimi rreth përshtypjeve – se cili nxënës si e ka dëgjuar dhe kuptuar përrallën.

## Shkathhtësia e të dëgjuarit aktiv

Dëgjimi aktiv është aftësia për të dëgjuar folësin dhe për të kuptuar mesazhin që ai ose ajo dëshiron të përcjellë. Dëgjimi aktiv përfshin aftësi shtesë gjatë procesit që mundësojnë verifikimin dhe kuptimin e informacionit. Përveç kësaj, tabela tregon aftësitë dhe mënyrat përmes të cilave mundësohet përdorimi i dëgjimit aktiv për komunikim efektiv.

Shkathhtësia	Kuptimi
Rezimimi	Formimi i përfundimit, rezime nga më shumë informacione të shprehura.. Në këtë rast duhet të kemi parasysh saktësinë, gjegjësisht korrektësinë e përfundimit. <i>Shembull: „Do me thënë, për tre gjërat, për të cilat folët janë ...e para, ... e dyta, ... e treta?“</i>
Riskjarimi	Kontrollimi se sa mirë e keni kuptuar mesazhin ose disa nga faktet, mendimet, vendimet, kronologjinë e ngjarjeve. <i>Shembull: „Do me thënë, të kqartësojmë se hapësira jote është e zënë të Hënë dhe të Mërkurë“.</i>
Parafrazimi	Interpretimi vetanak i asaj që thuhet nga ana e folësit në formën e informatës kthyesë. Kjo aftësi na mundëson që të bëjmë të ditur se folësi dëgjohej, dhe në të njëjtën kohë, të japim shtysë për të vazhduar fjalimin. <i>Shembull: „Nëse mirë ju kuptova, ajo që ka ndodhur në kohën e ngjarjes i ka dekurajuar pjesëmarrësit e tjerë“.</i>
Spjegimi	<i>Interpretimi vetanak i një deklaratë të dhënë. Kjo aftësi është shumë e dobishme nëse dikush nuk flet mjaft qartë.</i> <i>Shembull: "Kjo që po thoni është e lidhur me..."</i>
Pyetje të hapura – të mbyllura	Parashtrimi i pyetjeve, të cilat do të nxisin diskutimin e mëtutjeshëm. <i>Shembull: „Çka ndodhi më pas?“ ose: „Si ndikoi ajo në qëndrimin tënd,“ ose „Për çka u morrët vesh,“?</i> Pyetje të hapura janë ato, të cilat nxisin komunikim të mëtutjeshëm, ndërsa tek pyetjet e mbyllura, përgjigjet janë me PO dhe JO.
Inkurajimi	<i>Potenconi momentet e dobishme nga situata, e cila është temë diskutimi dhe nxitni interes tek folësi, që të vazhdojë të ndajë përshtypjet.</i> <i>Shembull: "Kjo me të vërtetë ishte mjaft interesante dhe e dobishme"</i>
Lënia e hapësirës (qetësia)	Lejimi i një kohe ndërmjet asaj që personi dëshiron të thotë dhe vazhdimin të diskutimit nga folësi. Heshtja mund ta lejojë folësin të përfundojë së foluri ose mund të ndihmojë në absorbimin e asaj që është thënë.
Lidhshmëria	Deklaratat/pyetjet/komenete mund të jenë të lidhura nga ana e folësit. <i>Shembull: „Dhe më pas, si vazhduat me ngjarjen,“?</i>

## Komunikimi joverbal

Komunikimi joverbal nënkupton që dërguesi dhe marrësi i mesazhit komunikojnë me njëri-tjetrin duke përdorur **mënyra joverbale**. Shumë shpesh komunikimi verbal dhe joverbal përdoret në kombinim, dhe gjithashtu komunikimi joverbal përdoret në procesin e dëgjimit aktiv për t'i treguar folësit se ai dëgjohet dhe kuptohet. Në komunikimin joverbal, pjesëmarrësit përdorin edhe **shenja me kuptim të ndërsjellë, gjeste** ose **lëvizje** të kuptueshme reciproke që për një pjesë të grupit mund të jenë të pakuptueshme dhe të panjohura. Prandaj, sa herë që jeni në situatë për të komunikuar në grup, përpiquni të kuptoni komunikimin joverbal përmes të cilit do të mësoni më shumë për raportet ndërmjet pjesëmarrësve në komunikim dhe do mundeni t'ju qaseni atyre në mënyrë të përshtatshme më tej në proces.

Shfrytëzimi i shenjave, gjesteve dhe lëvizjeve jo-verbale mund të jetë konfuz për ju, por edhe anasjelltas, nëse përdorni forma të caktuara të komunikimit joverbal, pjesëmarrësit e tjerë mund të ndihen konfuz dhe të mos kuptojnë përmbajtjen, të cilën dëshironi që t'a përcjellni.

Ekzistojnë disa forma standarde të komunikimit joverbal si për shembull tundja e kokës në shenjë konfirmimi, apo përkulja përpara kur doni të përshëndesni dikë, por edhe në këto situata duhet pasur kujdes sepse **në kultura të ndryshme disa shenja mund të kenë interpretime të ndryshme**.






Nëpërmjet komunikimit joverbal, shpeshherë jepen informacione konfirmuese, se folësin e keni dëgjuar dhe e kuptoni. Disa nga format dhe mënyrat që përdoren janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Shkathtësia	Kuptimi
Shprehja e fytyrës	Fytyra jonë i shpreh emocionet tona. Lejoni që ajo të ndodhën gjatë kohës së komunikimit, paraprakisht mundohuni që të krijoni paqartësi tek bashkëfolësi.
Kontakti me sytë	E inkurajon folësin të vazhdojë, të flasë dhe i ofron mbështetje.
Gjuha e trupit	Duhet të qëndrojmë drejt, të jemi në një distancë të caktuar me folësin dhe t'a shohim në sy, deri sa ai flet dhe të shprehim interes.
Gjesticulacionet	Gjesticulacionet bëhen me ndihmën e duarve, si psh: duart e hapura janë shenjë se jemi të hapur, duart e kryqëzuara janë shenjë se jemi të mbyllir, dhënia e duarve është shenjë për përkrahje dhe ndihmë, etj.
Racionalizimi i hapësirës	Lënia e distancës komode ndërmjet folësit dhe dëgjuesit. Mungesa e hapësirës, respektivisht, hyrja në hapësirën personale të dikujt, mund të shkaktojë shqetësim ose jorehati.



## Ushtrim për komunikimin joverbal

Ushtrimi 1: Loja me bashkim pjesësh të figurës



-  Merrni 4 loja të njejta me bashkim figurash me madhësi mesatare, për të cilat nevojiten 20 minuta që të bashkohen;
-  Ndani pjesëmarrësit në 4 grupe me nga 3 ose 4 persona;
-  Jepni instruksionet se, secili grup duhet që pa folur t'i ngjeshë pjesët e lojës. Është e lejuar që të tregohen pjesët e fotografisë, gjestikulacione me duar, shprehje të fytyrës dhe gjuhën e trupit;
-  Në mënyrë ideale për 20 minuta grupi duhet që t'i bashkon pjesët pa folur fare;
-  Pas përfundimit të ushtrimit do të diskutohet për përshtypjet e procesit. Çka i frustronte pjesëmarrësit? Çka ishte më e lehtë për ta? Çka ishte më e vështirë? Si arritën që të merren vesht se cila pjesë në cilin vend duhet vënë?

## Komunikimi elektronik



Komunikimi elektronik është një lloj shumë i zakonshëm i komunikimit me shkrim, i cili përveç fjalëve përfshin edhe **përdorimin e shenjave dhe simboleve, imazheve, grafikëve, videove** dhe të ngjashme. Komunikimi elektronik është shumë i përhapur përmes **rrjeteve sociale** dhe përmes shkëmbimit të mesazheve zyrtare përmes **internet veglave të komunikimit**. Në kushtet e një pandemie me Covid 19, u përdor edhe më shumë komunikimi elektronik për të kryer punë në distancë me ekipe të mëdha dhe për lloje të ndryshme aktiviteteve.

Në komunikimin elektronik është shumë e rëndësishme njohja e bashkëbiseduesit dhe niveli i aftësisë së tij në komunikimin elektronik dhe përshtatja e mesazhit dhe mënyra e dërgimit në përputhje me rrethanat. Gjithashtu, në varësi të qëllimit të komunikimit dhe mesazhit që do të transmetohet, mund të zgjidhen lloje të ndryshme të veglave të komunikimit. Për shembull, për komunikim zyrtar me mësuesit, drejtorin dhe shërbimin profesional, duhet të përdoret **posta elektronike**, ndërsa për shkëmbimin e informacionit mes shokëve të klasës, mund të zgjidhni një nga veglat e komunikimit si **për shembull Viber**, ose të ndani informacionin në **Instagram** dhe **Facebook**.

Nëse dërgoni porosi të shkruar nëpërmjet postës elektronike, është me rëndësi që të kihen parasysh edhe disa rregulla, të cilat shfrytëzohen në komunikimin me shkrim si për shembull:

-  Mesazhi gjithmonë duhet që të fillojë me përshëndetje zyrtare deri tek personi, të cilit i drejtohem: „I nderuari drejtor,, ose „ E nderuara mësuese Biljana,,;
-  Teksti i mesazhit duhet të ndjekë rrjedhën e zakonshme dhe të fillojë me një hyrje të vogël, arsyetim dhe përfundim;



-  Në mesazh çdo herë duhet të qëndrojnë data, koha, numri i pjesëmarrësve, emrat e shollave ose personave, të cilët duhet të jenë prezent, e të ngjajshme, nëse bëhet fjalë për ndonjë ngjarje;
-  Mesazhi duhet të përfundon me përsëritje dhe nënshkrim me emrin dhe mbiemrin tuaj dhe funksionin në Paralemntin e nxënësve, si dhe numër kontakti, në të cilin mundet që t'ju thirrin.

## Përfundimet për komunikimin efektiv

- » Shfrytëzoni gjuhën e qartë të trupit që të tregoni se jeni duke dëgjuar (shikimi, ndjekja e drejtë, pohimi me kokë, etj.);
- » Dëgjoni atë që flet pa e ndërprerë fare;
- » Përsëritni atë se çka thotë folësi, që të vërtetoni se e keni kuptuar mirë;
- » Pyetni nëse ka diçka, të cilën nuk e keni kuptuar;
- » Mos lejoni që vëmendjen t'jua tërheqin disa tinguj, telefoni celular (shkyçni ato!), atë që bëjnë të tjerët, etj ;
- » Mos lejoni që vëmendjen t'jua tërheq dikush për tiparet e të tjerëve, stilit të të folurit, veshjes të folësit ;
- » Të largohemi nga sharjet, përqeshjet, stereotipet, shprehjet e nivelit të ulët;
- » Me të vërtetë dëgjoni, pa menduar se si do të reagoni, deri sa fytyra nuk përfundon së foluri;
- » Të jeni të vetëdijshëm për qëndrimin tuaj personal dhe largojuni sjelljeve të gjykimeve.




## 4.2 Debatimi

### Çka është debati?

**Debati** është një diskutim i organizuar dhe argumentuar, me rregulla dhe që zhvillohet më së paku ndërmjet dy palëve, të cilët kanë mendime të ndryshme ose të kundërta ose kanë kuptim të ndryshëm për mënyrën e arritjes së ndonjë qëllimi. Debati mund të paraqitet si në jetën private, poashtu edhe në sferën publike dhe shkencore.

## Debati i strukturuar





Vetë nocioni, debat i strukturuar, tregon se bëhet fjalë për mënyrën e kontrolluar të debatit, i cili i nënshtrohet disa rregullave, për dallim nga debatet, të cilat shpesh na ndodhin në jetën private. Karakteristikat e debatit të strukturuar janë:

-  Atmosferë e kontrolluar, ku ekzistojnë disa rregulla të caktuara për fer diskutim;
-  Folësit duhet të jenë të kujdesshëm, t'i përmbahen temës së saktë të diskutimit, e cila ju është dhënë;
-  Koha, të cilën e kanë në dispozicion për të folur dhe argumentet që shfrytëzohen gjatë kohës së debatit.

## Debati garues (konkures)

Debati formal në arsim, shfrytëzohet për qëllime arsimore dhe mban emrin debat garues ose konkures. Karakteristikat e debatit garues janë:

### Çka është debati garues (konkures)?

-  Disciplina shkollore dhe akademike – zhvillimi i argumentimit dhe të menduarit kritik;
-  Turnire, në të cilat vendoset për më të mirin e ndeshjes;
-  Zhvillimi i aftësive të nxënësve për argumentim, aftësi ekipore dhe të liderit, shkathtësi komunikative, të folurit në publik dhe të menduarit kritik;
-  Debati garues karakterizohet me formalitetin e strukturës, përkufizimin e konfliktit, diskutim dhe rezultate të argumentuara, i cili është rezultat i vendimit të gjyqtarit.

## Struktura e debatit

Varësisht nga formati, **çdo debat ka rregullat e veta** në lidhje me numrin e palëve në debat, numrin e ekipeve, numrin e folësve, kohëzgjatjen dhe renditjen e fjalimeve. Mungesa e strukturës formale shpesh herë shoqërohet me një përkufizim joadekuat ose të pasaktë të konfliktit. Në mënyrë që debati të strukturohet dhe organizohet konkretisht me një konflikt të përcaktuar në mënyrë specifike, është e nevojshme që ajo të përmbajë një tezë të qartë, eksplicite dhe konkrete. Debatet akademike karakterizohen nga shumë rregulla, të cilat duhet të ndiqen gjatë debatit si për mënyrën e debatimit, ashtu edhe për formimin e ekipeve të debatuesve dhe mënyrat e paraqitjes së tezave dhe argumenteve.

## Përkufizimi i konfliktit

Thelbi i debatit nuk konsiston në konfliktin midis së mirës dhe së keqes, as edhe ndërmjet konfliktit midis të së vërtetës dhe të pavërtetës ose konfliktit midis fakteve dhe mendimeve. Gjatë debatit, vjen deri tek një konflikt i vlerave dhe parimeve. Marrë në mënyrë të pavarur, çdo parim ka vlerë dhe vlefshmëri dhe meriton mbështetje në formën e argumentimit. Por, kur dy parime valide janë në konflikt, duhet të merret një vendim, për atë se cili është më i rëndësishëm. Ky është edhe thelbi i gjithë debatit. **Nëse nuk do të ekzistonin konfliktet, nuk do të ekzistonin as edhe debatet.**

## Formatet e debatit

Në debatet nëpër shkolla, rekomandohet të definohet numri i ekipeve dhe numri i folësve. Zakonisht rekomandohet **një ekip afirmativ (pohues) dhe një ekip negativ (mohues)**, secili ekip me nga tre folës. Ekipi afirmativ është ai që mbështet tezën, ndërsa ekipi negativ, është ai që e mohon tezën. Më pas, secilit prej folësve mund t'i caktohet një rol të veçantë në drejtim të paraqitjes së argumenteve dhe kundërshtimit të pikëpamjeve me ekipin tjetër. Ilustrimi më poshtë tregon të dyja ekipet.



Ekipi afirmativ  
(tre folës)




Ekipi mohues  
(tre folës)

Në realizimin e debatit, saktësisht përcaktohet koha e të folurit për secilin debatues, si dhe koha e përgjithshme e debatit.

## Çka është teza dhe argumenti?

Nocioni tezë ose rezolutë, rrjedh nga fjala e vjetër greke “thesis” që do të thotë vendosja e një deklaratë, e cila kërkon fakte - prova ose pozicionimin në një anë.

Sot termin tezë e interpretojmë si një term, i cili duhet të vërtetohet, temë, e cila duhet debatuar, më saktë, temë, e cila shqyrtohet nga ana afirmative (ana që mbështet tezën) dhe negative (pala që mohon tezën).



### **Teza nevojitet të jetë me të dhëna:**

- » „Arsyetohet që në Mars ka jetë“
- » „Votimi duhet të jetë proces i domosdoshëm“

### **Teza nevojitet të jetë bashkëkohore dhe aktuale**

- » „Digjitalizimi i arsimit duhet patjetër të ndodhë“.
- » „Lufta kundër ndotjes është prioritet “.

Tezat vërtetohen nëpërmjet argumenteve. **Argumentimi** është mënyrë e të folurit, ku gjatë disa deklaratave (arsye ose supozime) ofrohen si përkrahje të deklaratave të tjera (thënie ose përfundime). Secili argument në vete duhet që t'i përmbajë elementet vijuese:

- » Thëniet
- » Sqarimin
- » Faktet
- » Lidhjet

Në vazhdim janë dhënë disa shembuj të tezave për debat në arsim.










- » „Duhet që të futen uniformat në të gjitha shkollat fillore“.
- » „Arsimi i lartë duhet të jetë pa pagesë“.
- » „Duhet të ndalohen video-lojrat me dhunë për fëmijët“.
- » „Mosha për të votuar në 16 vjet“.
- » „Duhet të hiqet arsimi i mesëm i detyrueshëm“.


Disa këshilla për debat:

- » Sulmoni qëndrimin e kundërshtarit dhe jo personalitetin e tij;
- » Saktësisht identifikoni argumentin, të cilin e kundërshtoni;
- » Jini të sjellshëm, të qetë, të sigurtë dhe jepni përshtypjen se jeni gati për debat;
- » Të keni kontrollë për kohën;
- » Në mënyrë vizuale komunikoni me gjyqtarin dhe publikun, dhe jo vetëm me shënimet tuaja;
- » Njiheni dhe pranoni ankthin (ajo është dukuri normale);
- » Nëse debati është zyrtar / formal, kriterijumet më të rëndësishme për bodim dhe rangim të debatuesve janë: shkathtësia e argumentimit, faktet, oragnizimi, mënyra e të prezentuarit, etj.

## Si të organizoni debat në shkollën tuaj?

Nëse dëshironi të organizoni një debat si Parlament i nxënësve, më së miri është që atë t'a bëni në bashkëpunim me arsimtarët, të cilët janë të përfshirë në punën e parlamentit. Hapat e mëposhtëm do t'ju ndihmojnë të organizoni debatin:

-  Diskutoni me anëtarët e Parlamentit të nxënësve, me qëllim që të përpiloni një listë tezash, për të cilat do të mund të organizoni debat në shkollë;
-  Kryeni një anketë me nxënësit, në të cilën ata do të votojnë për tezat, dhe më pas bëni një rradhitje të tezave në bazë të pikëve të marra. Teza e parë, me më shumë pikë, duhet të jetë teza për debatin e parë, ndërsa të tjerat mund t'i shpërndani përgjatë vitit shkollor;
-  Postoni temën publikisht, dhe më pas, kërkoni nga shokët tuaj të klasës, që të bashkohen me ekipet e debatit. Kufizoni numrin e ekipeve në mënyrë që të planifikoni dhe organizoni debatin;
-  Nga kandidatët formoni ekipe, ndërsa të interesuarve të tjerë, propozojuni që t'ju bashkohen në debatet e ardhshme përgjatë vitit shkollor;
-  Merruni vesht se kush do jetë në ekipin afirmues, dhe kush në ekipin negativ;
-  Së bashku me arsimtarët përgaditni plan për hulumtim të tezës edhe atë argumente “për” dhe argumente “kundër”;
-  Në kuadër të ekipeve përgaditni argumente në formë të shënimeve të shkruara bazuar në kohën e të argumentuarit;
-  Vendosni rregulla të qarta dhe caktoni një gjyqtar në debat;
-  Lini takim, njohtoni nxënësit dhe arsimtarët dhe zhvilloni garën;
-  Diskutini rreth përvojave!



## 4.3 Shkathtësitë hulumtuese dhe analitike

Me qëllim të nxitjes së aktiviteteve në tema të ndryshme, dhe në drejtim për të zgjidhur probleme të caktuara ose për të përmbushur disa nevoja, shpesh herë është e nevojshme të kryhen hulumtime për situatën. Hulumtimi është një proces i planifikuar dhe për këtë arsye anëtarët e Parlamentit të nxënësve duhet të posedojnë njohuri dhe shkathtësi bazë për hulumtim, aplikimin e disa metodave hulumtuese dhe mënyrën e analizës, përpunimin e të dhënave dhe nxjerrjen e konkluzioneve.

### Cilat janë elementet bazë për një hulumtim?

-  Tema e hulumtimit – tregon se, në cilën lëmi të jetës shkollore do të kryhet hulumtimi. Si shembuj për temën mund të jenë: dhuna në shkollë, procesi i mësimit, aktivitetet jashtëmësimore, etj.
-  Problemi ose nevoja për hulumtim tregon se, cili problem do të hulumtohet, gjegjësisht cila është nevoja, për të cilën do të kryhet hulumtimi. Si shembull për problemin/nevojën, mund të jetë: numri i madh rasteve të dhunës nga bashkëmoshatarët, dmth nevoja për të hetuar dhunën kibernetike.
-  Qëllimet e hulumtimit, ku hulumtimi ka një qëllim të përgjithshëm dhe më shumë qëllime specifike, të cilat dalin nga vetë ideja e kërkimit. Qëllimi i përgjithshëm i hulumtimit mund të jetë që të përcaktohen shkaqet e dhunës së bashkëmoshatarëve në shkollë, ndërsa si qëllime specifike mund të paraqiten: “Të përcaktohen situatat më të shpeshta, në të cilat paraqitet dhuna” dhe “Të krijohen profile të të miturve që kanë sjellje të dhunshme në shkollë. ”.
-  Hipotezat e hulumtimit janë supozime, përmes të së cilave hulumtimi do të vërtetohet ose do të hidhen poshtë. Si shembuj mund të jenë: "Nxënësit, të cilët shpesh luajnë lojëra të dhunshme janë të prirur ndaj dhunës kibernetike" dhe "Dhuna në shkollë ushtrohet njësoj nga djemtë dhe vajzat".
-  Ekzemplar i hulumtimit është grupi i përzgjedhur i nxënësve, me të cilët do të kryhet hulumtimi, gjegjësisht nga të cilët do të mblidhen informacione për të shpjeguar problemin dhe hipotezat. Nxënësit mund të zgjidhen nga të gjitha klasat e shkollës ose nga disa të caktuara, dhe të rriturit gjithashtu mund të përfshihen në anketë nëse është e nevojshme.
-  Metodot hulumtuese, të cilat përdoren mund të jenë anketa, analiza e dokumenteve, intervistat, fokus grupet, studim i rastit, etj. Këto metoda gjithashtu mund të kombinohen për të marrë të dhëna më të thella dhe më shumë në numër.
-  Metodot për analizën dhe përpunimin e të dhënave janë procedurat që do të zbatohen për të përpunuar të dhënat e mbledhura në mënyrë që të mund të merren disa përfundime. Si metoda, më së shpeshti në nivel shkolle dhe nëse hulumtimi kryhet në mënyrë të pavarur

nga nxënësit, do të përdoren metoda sasiore, si: shumat, mjediset, përcaktimi i përqindjes, si dhe cilësore: analiza e përmbajtjes.



Raport nga hulumtimi, i cili mund të përgatitet si dokument i shkruar ose në formë të disa produkteve individuale, si: broshura informative me të dhënat e fituara, infografikë, harta vizuale dhe grafikone etj.

## Çka është anketa dhe si përgaditet e relizohet?

Nëpër shkolla, në nivelin e organeve të nxënësve shumë shpesh bëhen anketa me nxënës dhe të rritur, dhe në atë drejtim do të përpunojmë karakteristikat e kësaj metode. Instrumenti kryesor në anketë është pyetësori.

Pyetësori është një instrument hulumtues, i cili përmban një sërë pyetjesh, me qëllim që të mbledhen informacione nga të anketuarit.

Elementet e pyetësorit janë:

- » Emërtimi
- » Pjesa hyrëse
- » Pyetje
- » Faleminderime dhe vërrejtje të tjera

Emërtimi i referohet emrit të pyetësorit, ku në vetë emrin, mund të përfshihen informacione, të cilat konkretizojnë ose tregojnë se për çfarë llojhulumtimii bëhet fjalë. P.sh.: “Pyetësor për hulumtimin e dhunës në shkollën tonë” ose “Pyetësor për qëndrimet e nxënësve për realizimin e aktiviteteve jashtëmësimore” etj.

Pjesa hyrëse shërben për t'i shpjeguar nxënësit, i cili plotëson se cili është qëllimin i hulumtimit, nga çfarë përbëhet pyetësori, sa dhe çfarë lloj pyetjesh përfshin, kush e kryen atë etj.


Pyetjet janë pjesa kryesore. Ato zakonisht organizohen në blloqe pyetjesh, ku çdo bllok pyetjesh i referohet një aspekti të caktuar të lëndës që hulumtohet. Një bllok pyetjesh gjithmonë janë ato demografike nëpërmjet të të cilave mblidhen informacione për karakteristikat demografike të të anketuarve, si: gjinia, moshë, klasa, vendbanimi, përkatësia etnike etj. Pyetjet mund të jenë:

- Të hapura, për të cilat nuk ofrohet paraprakisht opzione për përgjigje;
- Të mbyllura, përgjigjet e të cilave zgjidhen me një ose më shumë opzione të ofruara, dhe
- Gjysëm të mbyllura, të cilat përmbajnë opzione për të zgjedhur por, që njëra nga opsionet e dhëna është mundësi për të dhënë përgjigje personale.

Në vazhdim do të japim disa shembuj për disa pyetje, të cilat mund të shfrytëzohen në dizajnimin e pyetësorit:

 **Shembulli 1: A mendon se je i/e barabartë me fëmijët tjerë të rrethinës; rretho një përgjigje)**

- a. Po, jam i/e barabartë
- b. Jo çdo herë jam i/e barabartë
- c. Asnjëherë nuk jam i/e barabartë
- ç. Nuk e di

 **Shembulli 2: A ekziston dhuna në shkollën tuaj? (rretho një përgjigje)**

- a. Po
- b. Jo

 **Shembulli 3: Në cilat nga vendimet e poshtëshënuara, deri tash, në shkollën tënde ke marrë pjesë? (mund të rrethosh më shumë përgjigje)**

- a. Kur zgjedhim kryetarin e klasës
- b. Kur vendosim se, ku do të shkojmë në ekskurzion
- c. Çka mendoj për kushtet, në të cilat mësoj
- ç. Çka mendoj për arsimtarët
- d. Çka mendoj për përmbajtjen e mësimit
- e. A kam nevojë për mësim plotësues/edukim nga ndonjë lëndë mësimore
- f. Cilat aktivitete të lira duhet të organizohen në shkollë
- g. Çka duhet të përmbajë manifestimi vjetor (shfaqja)
- h. Deri më tani nuk kam marrë pjesë në sjelljen e vendimeve në shkollë





**Shembulli 4: Në shkallën prej 1 – 5 ku 1 tregon Aspak nuk pajtohem, ndërsa 5 Plotësisht pajtohem, shënoni qëndrimin tuaj tek qëndrimet vijuese:**

	1	2	3	4	5
Aktivitetet jashtëmësimore janë të përshtatshme për nevojat e mija					
Kohëzgjatja e pushimeve është e mjaftueshme					

Të dhënat e fituara nga anketa grupohen, kodohen (nëse është e nevojshme) futen dhe përpunohen duke përdorur metoda cilësore dhe sasiore të cilat janë shpjeguar më parë, si dhe duke përdorur tabela në Excel dhe Word, gjë që është mjaft e mjaftueshme për hulumtimin, të cilin e realizojnë nxënësit.

## 4.4 Shkathtësitë për prezentim

Si anëtarë të Parlamentit të nxënësve dhe përfaqësues të shokëve tuaj të klasës, ju, shpesh herë do të viheni në rol për të prezentuar disa qëndrime, situata, të dhëna dhe informacione. Prandaj, është e nevojshme që anëtarët e Parlamentit të nxënësve të zhvillojnë shkathtësi të mira prezantuese, si para një publiku më të vogël, ashtu edhe në situata të një auditori më të madh. Aftësitë e prezantimit përfshijnë zhvillimin e shkathtësive për të:

- Të folurit
- Gjuhë e trupit
- Përgaditjen e prezantimit






### Të folurit dhe gjuha e trupit

Shpesh herë, në shkollë, nxënësit janë të vënë para sfidës për të folur për një temë të caktuar e cila është e rëndësishme për ta dhe për të cilën duhet të përfaqësojnë qëndrimet e nxënësve të tjerë. Pavarësisht, nëse bëhet fjalë për ndonjë prezantim gojor të disa informacioneve të caktuara, të folurit duhet të jetë i strukturuar dhe të ndiqen disa rregulla. Nëse fjalimi është planifikuar që më parë, do të keni mundësi të përgatitni dhe shkruani fjalimin tuaj, por nëse bëhet fjalë për ndonjë situatë të paplanifikuar, ju duhet të keni një kornizë të caktuar, në bazë të së cilës do të mbani fjalimin tuaj.

Disa këshilla kryesore, të cilat mund të ndihmojnë në planifikimin e të folurit efektiv:



Para se të filloni me përgaditjen e të folurit, siguroni informacione për: **temën, publikun, kohën, të cilën e keni në dispozicion dhe hapësirën**. Këto janë variabla të rëndësishme, të cilat mund të ndryshojnë drejtimin, në të cilin do të rrjedh fjalimi i juaj.

-  Hulumtoni për temën dhe përgaditni argumente , të cilat do t'i prezentoni.
-  Fjalimi duhet të përmban tre pjesë: pjesën hyrëse, përshkrimin dhe argumentet, pjesën përfundimtare. Në pjesën hyrëse është e preferueshme që të përdoren disa mendime ose citate për temën, të cilat do të zgjojnë interes tek publiku. Tek argumentimi, është e nevojshme që argumentet t'i thoni në mënyrë të qartë dhe një nga një. Në pjesën përfundimtare, theksoni poentën kyçe dhe bëni një rezymë të shkurtër respektivisht jepni një përfundim.
-  Shkruani atë që duhet t'a flisni dhe mbani para vetes verzionin e shkruar deri sa flisni ose të keni shënime , të cilat do ju shërbejnë për t'u kujtuar.
-  Kur flisni, ndiquni nga rregullat e mëposhtme: mbani kontaktin me sy me publikun, flisni qartë dhe me zë të lartë, flisni në mënyrë të kuptueshme, përdorni gjuhën letrare, përshtatni nivelin e publikut, të cilit po i drejtoheni, mbani llogari për kohën që keni në dispozicion, bëni pushime të shkurtra dhe merrni frymë siç duhet.
-  Gjuha e trupit duhet të shoqërojë fjalimin tuaj dhe t'ju ndihmojë me të folurit tuaj. Përdorni në mënyrë të moderuar gjeste të caktuara, mimika të fytyrës dhe lëvizje të duarve dhe trupit.

Në vazhdim është dhënë një shembull i fjalimit të Avokatit të popullit të nxënësve gjatë paraqitjes deri tek kryetari i Kuvendit Talat Xhaferi me rastin e Ditës botërore të fëmijëve.

## KËRKESË nga Fëmijët, për të Drejtat e Fëmijëve

**I nderuari Kryetar i Kuvendit, z. Talat Xhaferi,**

*NE EMËR TË TË GJITHË FËMIJËVE DHE TË RINJVE , Ju drejtohem ne nxënësit-Avokatët e nxënësve, në Ditën botërore të fëmijëve fëmijëve dhe festimit të 30 vjetorit nga miratimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, me kërkesë për vëmendje më të madhe ndaj të drejtave tona dhe kushteve reale për realizimin e të drejtave të çdo fëmije.*

*SOT, Zëri i Fëmijëve ju kujton detyrimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, për të siguruar që çdo fëmijë të ketë të drejtën për të ushtruar të drejtën e tij/saj për një emër, shtetësi dhe identitet, një jetë të sigurt, liri dhe liri. siguria e personit. E drejta e çdo fëmije për një shtëpi, ushqim të shëndetshëm, dashuri dhe kujdes, standard të përshtatshëm jetese, arsimim, nivel më të lartë të kujdesit shëndetësor. E drejta për t'u mbrojtur nga dhuna, abuzimi dhe abuzimi, pa diskriminim, duke respektuar interesat më të mira të fëmijës dhe duke vlerësuar mendimin e tij!*

*NE FËMIJËT shprehim shqetësimin tonë për situatën me të drejtat e fëmijëve, aq më tepër që shumë fëmijë sot nuk njihen nga sistemi, janë ligjërisht të padukshëm, ndaj të drejtat e tyre nuk janë të disponueshme që nga lindja.*

*NE FËMIJËT jemi lënduar nga pamja e fëmijëve të shtrirë në rrugë, fëmijët e pastrehë dhe përdorimi i fëmijëve për të siguruar të ardhura për familjen. Jemi të lënduar nga refuzimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara, paarritshmëria e kopshteve dhe shkollave dhe mungesa e mbështetjes adekuate. Por na shqetëson edhe heshtja e institucioneve ndaj dhunës ndaj fëmijëve dhe barazimi i saj me lojën e fëmijëve, si dhe mungesa e komunikimit dhe respektimit të diversitetit, edhe pse jemi të ndryshëm në shumë arsye.*

*NE FËMIJËT nuk kemi paragjykimë, nuk zgjedhim shok sipas ngjyrës së lëkurës, statusit të familjes, gjuhës që flasim... Të gjithë duam të luajmë, të qeshim, të krijojmë, por edhe të ndihmojmë. së bashku. Por edhe ne fëmijët duam të dëgjohejmë dhe të pyetemi për shumë gjëra që të rriturit ende mendojnë se nuk i kuptojmë.*

*Prandaj, NE KËRKOJMË nga ju që të keni gjithmonë parasysh interesin tonë më të mirë, por sa herë që është e mundur, na lejoni të shprehim mendimin tonë, të respektojmë dhe vlerësojmë idetë tona, na lejoni të marrim pjesë në vendim-marrje që ndikojnë dhe na tangojnë ne fëmijëve.*

*I nderuar Kryetar,*

*TË GJITHË FËMIJËT janë të barabartë në të drejtat, prandaj KËRKOJMË të sigurojmë TË DREJTAT E FËMIJËVE QË T'Ë GËZOJMË ÇDO DITË, NE JETË. Çdo fëmijë duhet të ketë një certifikatë lindjeje, pra një identitet, por edhe një shtëpi ku do të jetojë me dashuri, përkujdesje dhe përkrahje . Çdo fëmijë duhet të jetë në gjendje të ndjekë kopshtin dhe shkollën, ku do të fitojë njohuri dhe aftësi. Për të siguruar që çdo fëmijë të ketë akses në kujdesin adekuat dhe cilësor shëndetësor dhe që çdo fëmijë të respektohet dhe pranohet, pavarësisht nga diversiteti.*

*NE FËMIJËT jemi kundër dhunës dhe nuk duam fyerje dhe nënçmime, e veçanërisht vlerësojmë kur na pyesin çka ne mendojmë. Nuk duam që të jemi veç vëzhgues të heshtur por, KËRKOJMË nga ju të rriturit të na respektoni, të na kyçni dhe na dëgjeni!*

*Prandaj, në Kuvend duhet të sillen ligje, të cilat do na mundësojnë të drejtat e vërtetuara në Konventën.*

*Fundja, të gjithë ju, të rriturit sot, dikur keni qenë fëmijë, dhe e dinit se sa e vështirë është të jeni këtu, por si mos me qenë.*







*Ne fëmijët nuk kërkojmë diçka të pamundur, të porealizueshme, por diçka që kemi të përbashkët – KËRKOJMË TA NA I LEJONI TË GJITHA TË DREJTAT E FËMIJËVE NË REALITET, PËR ARSYE SE TË GJITHË JEMI TË BARABARTË NË TË DREJTAT!*

## Përgaditja e prezentimit

Prezantimi nënkupton paraqitjen me shkrim të të dhënave, fakteve dhe informacioneve për një situatë të caktuar dhe krahas informacionit me shkrim, prezantimi shoqërohet me shpjegim gojor. Prezantimi ndihmon në strukturimin më të lehtë të një prezantimi dhe në të njëjtën kohë, i lehtë mundësinë publikut që të kthehet në një pjesë të prezantimit dhe të kujtohet përmes shënimeve që paraqiten me shkrim.

Sot, më së shpeshti përdoret **PowerPoint** për të bërë prezantime, por ka edhe vegla të tjera elektronike, të cilat mund të shërbejnë për të përgatitur një prezantim. Përveç prezentimit kompjuterik, prezentimi mund të kryhet duke përdorur **flip - çart, tabela, letër dhe markera**, si dhe duke përdorur fotografi, materiale të printuara etj.

Disa këshilla kryesore gjatë përgaditjes së një prezantimi në **PowerPoint**:

-  Prezantimi i paraqitet publikut në formatin kohor, të cilin e dispononi. Megjithatë, rekomandohet **jo më shumë se 15 minuta prezantim efektiv** para publikut.
-  Prezantimi duhet të jetë **interesant dhe interaktiv**, në prapavijë bazuar me temën dhe me karakteristikat e publikut.
-  Shfrytëzoni madhësinë e duhur dhe formën e thjeshtë të shkronjave, që do të jenë të **lexueshme dhe të kuptueshme**. Sigurohuni që teksti të jetë i lexueshëm nga hapësira, në të cilën do të prezantoni. Është mirë që shkronjat të jenë në një ngjyrë të kundërta me sfondin.
-  Prezantimi duhet të përmbajë **pak tekst** – vetëm poentat kyçe, të cilat doni t'i përcjellni, ndërsa të ketë më **shumë të dhëna, fakte, grafikone, fotografi por**, mundet edhe ndonjë link videosh.
-  Në një sllajd, zakonisht duhet të vihen deri më **4 fakte**, të cilat duhet të jenë të pandara, fjali të shkurtëra me jo më shumë se dy rreshta secili fakt.
-  Përgatituni për prezantimin, ashtu që do të hulumtoni dhe të jeni në gjendje që të mos lexoni nga sllajdet, por të mbani **kontakt me publikun** gjatë prezantimit.

Edhe në rastet kur flisni edhe kur mbani ndonjë prezantim, është e nevojshme që paraprakisht të ushtroni, me qëllim që të arrihet ndjenja e kohës që keni në disponim, ngjyrën e zërit, qartësinë e të folurit, etj. Në vazhdim janë dhënë disa sekuenca sllajdesh nga një prezantim mjaft efektiv.

Во продолжение дадени се извадоци сладови од ефективна презентација.

### Faktorët jo të favorshëm për participim

- Format tradicionale për tretman kah fëmijët – vlerësohet dëgjueshmëria dhe pasiviteti;
- Klima e përgjithshme sociale, e cila nuk kërkon dhe nuk nxit pjesëmarrje të vërtetë të fëmijëve ose të rriturve;
- Doktrina e përgjithshme – e cila mbizotëron në arsimin tonë, ku prej nxënësit nuk kërkohet pjesëmarrje aktive.



### Pjesëmarrja e fëmijëve

është e drejtë njerëzore - nëse fëmijëve u mohohet e drejta e tyre për pjesë - marrje, ajo do të thotë u janë thyer të drejtat e tyre.

paraqet parakusht për qytetërim demokratik

është nevojë bazike për zhvillim të shëndetshëm njerëzor

mundëson përmirësimin e kualitetit të rregullave, të cilat i tangojnë fëmijët

garanton përgjegjësi më të madhe të fëmijëve për aktivitetet e ndërmarura rregullave, të cilat



### Puna në grupe të vogla Shkalla e pjesëmarrjes (PADLET)



### Pjesëmarrja në procesin e sjelljes së vendimeve

Shkolla nxënësve duhet që t'ju mundëson që në mënyrë aktive të marrin pjesë në të gjitha proceset, në të cilat sillen vendimet në nivel të shkollës, që të mundet të përcillen qëndrimet dhe i interesat tek të gjithë nxënësit.

Parlamenti i nxënësve nëpërmjet përfaqësuesve të vet merr pjesë në Këshillin e prindërve dhe Këshillin e rsimtarëve

Në mbledhjen e Këshillit të shkollës thirren edhe asistojnë edhe dy anëtarë nga Parlamenti i nxënësve por, pa të drejtë vote.



## 5. Përgaditja dhe realizimi i iniciativave të nxënësve

### 5.1 Nocioni për iniciativat e nxënësve, aktivizmin dhe vullnetarizmin

Iniciativat mund të definoohen si **ide për zgjidhjen e disa problemeve** ose për plotësimin e nevojave të një grupi ose komuniteti të caktuar. Kur bëhet fjalë për iniciativat rinore, këto janë propozime, aksione dhe ide, të cilat janë dhënë nga nxënësit dhe të rinjtë në drejtim për të zgjidhur problemet, me të cilat ballafaqohen ose që janë të rëndësishme për komunitetin e gjerë ku jetojnë.

Në jetën dhe në organizimin e nxënësve, iniciativat e të rinjve zënë një vend qendror. Në fakt, çështja e organizimit të nxënësve në masë të madhe konsiston pikërisht në **përmirësimin e kushteve për mësim** dhe zhvillim përmes propozimeve dhe ideve nga ana e nxënësve, gjë që gjithashtu paraqet edhe praktikën e të drejtës për pjesëmarrje, për të cilën diskutuam më herët në kuadër të dorracakut.

Iniciativat të drejtojnë për proaktivitetin dhe aktivizimin e nxënësve dhe organeve të tyre përfaqësuese në shkollë. Prej aty, nocioni **aktivizëm rinor** në mënyrë me precize përfshin aktivitete individuale ose procese grupore që rezultojnë me ndryshime pozitive në mjedis ose sjelljen e vendimeve, që është më shumë një reflektim i nevojave dhe dëshirave të mjedisit. Si forma të aktivizimit të të rinjve, mund të paraqiten përfshirja në organizatat e nxënësve, organizatat rinore, vullnetarizmi në shkollë dhe mjedis, pjesëmarrja në aksione dhe aktivitete humanitare dhe ekologjike, etj.

Aktivitetet, të cilat realizohen nga ana e nxënësve dhe të rinjve në kuadër të iniciativave të tyre ose nëpërmjet formave të aktivizimit rinor zakonisht realizohen në baza vullnetare. Prej këtu, angazhimi i nxënësve dhe të rinjve në shkollë dhe mjedis, për qëllime bamirësie dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe quhet **vullnetarizëm**.

#### Cilat janë përfitimet e nxënësve nga angazhimi i tyre në iniciativa të ndryshme?

Nëpërmjet pjesëmarrjes së nxënësve në iniciativa dhe aksione, fitohen disa përfitime ndërmjet të cilave do kishin përfituar:

- » Përfitimi i përvojës;
- » Përvetësimi i njohurive dhe shkathtësive të reja;
- » Zhvillimi i kreativitetit, shkathtësitë e liderit dhe punës ekipore;
- » Zhvillimi i principeve për përgjegjësi dhe llogari-dhënie;
- » Kontributi për të mirën e mjedisit;
- » Zhvillimi i vlerave, si për shembull – solidariteti, etj.

## 5.2 Identifikimi i ideve dhe temave për aktivitetet e nxënësve

Puna e iniciativave rinore, aksioneve dhe projekteve siç edhe është përmendur, është një nga detyrat qendrore të Parlamentit të nxënësve. Parlamenti i nxënësve, nëpërmjet programit vjetor, të cilin nevojitet që t'a përgatit dhe zbaton, ka përballë mundësinë që të punojë për përmirësimin e situatës në shkollë dhe në mjedis. Në këtë drejtim, është veçanërisht e rëndësishme përfshirja e ideve për iniciativa dhe veprime në përgatitjen e programit vjetor.

Identifikimi i ideve dhe temave që do të punohet nëpërmjet Parlamentit të nxënësve ose në suazat e bashkësisë së klasës, duhet të realizohet **në mënyrë participative**, ashtu që, secili mund të kontribuojnë në identifikimin e problemeve dhe nevojave për të cilat duhet punuar. Për këtë qasje, diskutuam në pjesën e funksionalitetit të parlamentit të nxënësve, ku u theksuan disa mënyra për të identifikuar propozimet dhe idetë për pjesëmarrjen të nxënësve.

Varësisht nga kultura në shkollën tuaj, shprehjtë e nxënësve, kapacitetit të anëtarëve të Parlamentit të nxënësve, resurset dhe kohës, identifikimi i temave dhe mbledhja e ideve, mund të planifikohet si një **proces afatgjatë** që do të përfshin më shumë mënyra dhe më shumë nxënës, ose **si proces i kufizuar por gjithësi inkluziv**, për grupe dhe interesa të ndryshme.

Në kushtet kur duam të marrim shpejt propozime për tema dhe ide, gjëja më e thjeshtë është të zhvillojmë një diskutim në nivel të Parlamentit të nxënësve, në të cilin, përmes teknikës **stuhi ideshë** do të përpiqemi të marrim ide dhe tema për aktivitetet gjatë vitit. Ky aktivitet rezulton në një Listë **preliminare ideshë dhe temash**, e cila më tej duhet të ndahet me shokët e tjerë të klasës, arsimtarët dhe drejtuesit e shkollës në mënyrë që të plotësohet ose rishikohet me të dhëna nga të gjithë të tjerët, të cilët nuk ishin të përfshirë drejtpërdrejt në proces. Lista e ideve mund të shpërndahet publikisht në tabelën e lajmërimeve në shkollë ose përmes **mediemeve sociale** ku të gjithë mund ta shohin atë dhe të japin komente të argumentuara ose propozime për plotësim dhe ndryshim.

Nëse në listën e ideve dhe temave, përfshihen edhe përmbajtje të tilla, të cilat e tangojnë mjedisin më të gjerë, dhe jo vetëm shkollën, dmth. jo vetëm nxënësit, arsimtarët dhe udhëheqësinë, atëherë është e nevojshme që për ato tema dhe propozime konkrete, **të sigurohen të ardhura nga ana e mjedisit** respektivisht nga personat, të cilët në mënyrë direkte janë përgjegjës ose të prekur nga idetë dhe propozimet e dhëna. Si tema dhe ide që prekin mjedidit më të gjerë janë, për shembull: aksionet elokogjike në vendet e mjedidit, aktivitetet rinore për të zbukuruar mjedisin (për shembull, vizatimi i grafiteve në mur) ose aktivitete për të pasuruar jetën kulturore dhe argëtuese të të rinjve në mjedisin e afërt. (ndërtimi i një skate-parku) etj.

Lista e temave dhe ideve duhet kuptuar si **pikënisje** në punën e Parlamentit të nxënësve si organ përfaqësues i nxënësve. Kjo do të thotë se duhet të lihet hapësirë për plotësime shtesë apo ndryshime, natyrisht me përfshirjen paraprake të një rrethi më të gjerë nxënësish dhe aktorësh të tjerë në komunitet. Nga ana tjetër, lista e temave dhe ideve duhet të shërbejë si një mekanizëm **për vlerësimin e suksesit të Parlamentit të nxënësve** duke përcaktuar idetë e realizuara kundrejt asaj që ishte plani fillestar në fillim.

## 5.3 Hapat për planifikimin dhe realizimin e iniciativave dhe aksioneve

Pasi që të kemi identifikuar tashmë temat dhe idetë për iniciativat dhe aksionet e nxënësve, zgjidhet një nga ato tema ose ide, e cila më tej duhet planifikuar mirë. Parlamenti i nxënësve ose bashkësia e klasës mund të formojnë një ekip të veçantë për secilën ide ose temë që do të trajtohet. Më poshtë është një përshkrim i detajuar i tre hapave kyçe për planifikimin e një iniciative, të cilat mund t'ju shërbejnë ekipeve në atë proces.

### HAPI 1 – Konkretizimi i idesë dhe temës

- » Bisedë me nxënësit ose anëtarët e bashkësisë rreth ndonjë ideje konkrete, me qëllim të përfitimit të më shumë informacioneve;
- » Realizimi i Anketës për mendime dhe qëndrime, për metodat e veprimit, respektivisht si duhet t'ju qasemi ideve ose aktiviteteve, që duhet të përmbajë ajo iniciativë;
- » Bisedë me udhëheqësinë e shkollës rreth potencialit për realizimin e idesë;
- » Bisedë me persona kompetent të mjedisit, si për shembull me Kryetarin e komunës, rreth realizimit të iniciativës.

### HAPI 2 – Përpilimi i planit konkret

Pasiqë të marrim informatat plotësuese nga hapi i parë, vijon periudha e përgaditjes të një plani konkret, në të cilin ekipi duhet të bëjë marrëveshje dhe të sjell vendime. Plani, duhet që të përmbajë përgjigjet nga pyetjet e poshtëshënuara:

- » Çfarë aktiviteti do të realizojmë?
- » Kush do të na ndihmojë?
- » Kur do t'a realizojmë aktivitetin?
- » Ku do t'a realizojmë aktivitetin?
- » Cilët do të kyçim në aktivitet?
- » Sa mjete do na duhen për realizimin e aktivitetit?

Është më së miri që plani të përgaditet në formën e një dokumenti të shkruar/tabelë me pyetjet e lartëshënuara si dhe përgjigjet, të cilat më tutje do t'i ketë secili anëtar i ekipit dhe që do të mundet të paraprihet nga ai plan gjatë realizimit të atyre aktiviteteve, për të cilat në mënyrë konkrete do të jetë përgjegjës.



Në vazhdim është dhënë një shembull i tabelës për përgaditjen e tabelës.

### Plan për organizimin e aksionit të suksesshëm / inicijativa

Cila temë është më me prioritet në shkollën tonë?	
Çfarë aktiviteti do të realizojmë / çka të bëjmë?	
Pse suam që të realizojmë atë aktivitet – cilin problem duam të zgjidhim?	
Kush do të na ndihmojë?	
Kur do t'a realizojmë aktivitetin?	
Ku do t'a realizojmë aktivitetin?	
Kë do të kyçim në aktivitet? – shënoni numër	
Për cilat resurse do të kemi nevojë?	
Ku do t'a promovojmë aksionin tonë?	

### Hapi 3 – Komunikimi i aktiviteteve me nxënësit dhe, sipas nevojës edhe me rrethinën më të gjërë

- » Rrjet social përkatës – profilet oficiale të shkollës në rrjetet sociale;
  - Facebook: teskt më i gjatë dhe fotografi;
  - Instagram: fotografi,
  - Twitter: tekst i shkurtër, mesazh
  
- » Hashtag unikat (#) mesazh (gjatë shpalljes, mund të evidentohen institucionet ose organizatat, me ndihmën e të cilave u realizua aksioni.

## Hapi 4 – Zbatimi (realizimi) i iniciativës

Nxënësit-inicues të aksionit, duhet të kujdesen për atë se:

- Të gjithë personat, të cilët janë të kyçur në mënyrë direkte në zbatimin e aksionit të nxënësve të kenë ndonjë rol;
- Kushtet e motit janë të mira në periudhën e zbatimit të aksionit, nëse bëhet fjalë për një model hibrid të veprimit të nxënësve;
- I kanë siguruar të gjitha materialet e nevojshme si dhe ndihmë profesionale për realizimin/zbatimin e aksionit;
- Kanë krijuar grupe komunikimi në një platformë/aplikacion komunikimi përmes të të cilit do të kenë një pasqyrë të vazhdueshme të realizimit/zbatimit të aktiviteteve të planifikuara.

## Hapi 5 – Refleksimi i iniciativës

Pas përfundimit të iniciativës, ekipi duhet të bëjë reflektim/evaluim, duke i shfrytëzuar drejtimet e poshtëshënuara:

- A janë arritur rezultatet e planifikuara?
- Cilat ishin sfidat, të cilat e vështirësuan realizimin/zbatimin?
- Si funksiononte ekipi?
- A e mori ekipi përkrahjen e nevojshme nga palët e përfshira?

### 5.4 Metodat për realizimin e iniciativave dhe aksioneve

Çfarë qasje do të zgjedhë ekipi për realizimin e një ideje të caktuar, është një pyetje shumë e rëndësishme, nga e cila mund të varet suksesi i iniciativës, respektivisht arritja e rezultatit përfundimtar të caktuar. Në vazhdim janë dhënë përshkrimet dhe karakteristikat e disa metodave kryesore, të cilat rekomandohen të përdoren gjatë zbatimit e iniciativave.

#### Përfaqësimi i qëndrimeve dhe zgjidhjeve

- » Përfaqësimi paraqet një proces të organizuar të një prezentimi të argumentuar të ideve personale/ vetanake para bartësve të vendimeve, me qëllim që të arrihet një ndryshim pozitiv shoqëror.

- » Nga madhështia e aksionit të paramenduar, varet shumë se para kujt duhet të përfaqësohet (drejtorit të shkollës, Këshilltarit arsimor komunal, Kryetarit të komunës).
- » Në procesin e përfaqësimit, shumë e rëndësi shme është përkrahja nga ana e arsimtarëve por, edhe nga të punësuarit e tjerë nëpër shkolla.
- » Si tek secila iniciativë edhe tek përfaqësimi është shumë me rëndësi që të përgaditet një plan konkret me aktivitetet e rradhitura.

### Mbledhje me bartësit e vendimeve

- » Identifikoni se me kë do të takoheni dhe çka do të kërkonti.
- » Paraqitni idenë tuaj во një formë të shkruar deri tek bashkëbiseduesi.
- » Mos ndërhyjni me fjalë kur dikush tjetër flet. Shkruani. Mbani shënime.
- » Dëgjoni.
- » Informoni pjesëtarët e Parlamentit të nxënësve se çfarë mbledhje mbajtët, çfarë përshtypje dispononi.
- » Mos i mbani informatat veç për vete, ato nuk janë tuajat – ato janë të Parlamentit të nxënësve!

### Letër deri te bartësit e vendimeve

- » Memorandum (logo) të parlamentit të nxënësve
- » Shënoni se kujt po ja dërgoni (këndi i djathtë lartë)
- » Lënda – emri i kërkesës
- » Filloni paraqitjen në mënyrë korrekte („Të nderuar“)
- » Filloni me përshkrimin e problemit (shkurt dhe qartë, me fakte)
- » Tregoni se çka kërkonti të ndërmer ai organ dhe pse (shkurt dhe qartë)
- » Afat për të cilin pritët (me shkrim) përgjigje (psh. 5 ditë nga dita e deponimit të kërkesës)
- » Data dhe vendi (shënoni se kush e dërgon kërkesën)

## Aksionet shkollore

- » Fushatë për t'u marrë me dhunën ndërmoshatare;
- » Aksione ekologjike në oborr të shkollës;
- » Manifestime dhe aktivitete kulturore;
- » Aksione përparimin e procesit mësimore dhe aktiviteteve jashtëmësimore.

## Aksione në rrethinën

- » Fushatë për zvogëlimin e ndotjes së ajrit;
- » Fushatë për anti-diskriminimin në rrethinën e afërt;
- » Aksione ekologjike në parqet dhe hapësirat tjera të përbashkëta;
- » Aksione humanitare për ndihmë dhe përkrahje të grupeve të rrezikuara ose të marginalizuara;
- » Aktivitete përkujdesin e jetës shkollore, etj.



## 5.5 Resurse për arsimtarë dhe nxënës

Me qëllim të realizimit sa më efikas të pjesëmarrjes, si nga ana e të gjithë nxënësve po ashtu edhe nga ana e arsimtarëve dhe udhëheqësisë së shkollës si përkrahës të tyre, në vazhdim po japim disa linqe, të cilat mund të shfrytëzohen si resurse mjaft të dobishme:

- Link për resurset nga web-fleta e Byrosë për zhvillim të arsimit:

[https://www.bro.gov.mk/%D0%BF%D0%BE%D0%B4%D0%BA%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%BE%D1%80%D0%B8%D0%B8/?id-cat=118&customposttype=izdanija\\_kategorii](https://www.bro.gov.mk/%D0%BF%D0%BE%D0%B4%D0%BA%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%BE%D1%80%D0%B8%D0%B8/?id-cat=118&customposttype=izdanija_kategorii)

- Link deri tek resurset për pjesëmarrje të të rinjve, informata dhe të dhëna nga modelet për pjesëmarrje të të rinjve, të publikuara në web-fletën e Koalicionit të organizatës rinore SEGA:

<https://segaorg.mk/en/library#>

- Link deri tek resurset për përkrahjen e arsimtarëve, udhëheqësi dhe nxënës, të publikuara në web-fletën e Fondacionit për inicijativa arsimore dhe kulturore “Hap pas hapi”:

<https://www.stepbystep.org.mk/biblioteka>


- Link deri tek resurset për realizimin e inicijativave të të rinjve, të publikuara në Qendrën maqedonase për edukim qytetar:

<http://mk.mcgo.org.mk/>









ISBN 978-608-4857-71-6